

# STANDARDET PROFESIONALE TË OFICERËVE TË SIGURISË NË SHKOLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. 1314 Prot.

Tiranë, më 07.07. 2026

URDHËR

Nr. 343, datë 07.07. 2026

PËR  
MIRATIMIN E STANDARDEVE PROFESIONALE TË OFICERËVE TË SIGURISË  
NË SHKOLLA

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, pikës 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronjës “d” të pikës 5 të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” (ASCAP) dhe të urdhrit nr. 578, datë 11.11.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Standardeve profesionale të oficerëve të sigurisë në shkolla”, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



Dokumenti “Standardet Profesionale të Oficerëve të Sigurisë në Shkollë” u hartua nga Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP).

**Hartimi i dokumentit u koordinua nga:**

Gerti Janaqi

Esion Zgjana

Majlinda Ucaj

Eniana Veli

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

# TABELA E PËRMBAJTJES

|                                                                                                                                                                                                          |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| TABELA E PËRMBAJTJES.....                                                                                                                                                                                | 4  |
| HYRJE .....                                                                                                                                                                                              | 6  |
| Qëllimi i standardeve .....                                                                                                                                                                              | 6  |
| Rëndësia e standardeve .....                                                                                                                                                                             | 7  |
| Fusha e zbatimit .....                                                                                                                                                                                   | 8  |
| KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL .....                                                                                                                                                                    | 10 |
| Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë .....                                                                                                                                                              | 10 |
| Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar .....                                                                                 | 11 |
| Ligji nr. 18/2017, datë 23.02.2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” .....                                                                                                                       | 12 |
| Ligji nr. 108/2014, datë 31.07.2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar .....                                                                                                                         | 12 |
| Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 9.10.2018, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë” ..... | 13 |
| Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë” .....                                               | 14 |
| “Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Oficerëve të Sigurisë” .....                                                                                                                                         | 15 |
| PARIMET THEMELORE TË PUNËS SË OFICERIT TË SIGURISË.....                                                                                                                                                  | 17 |
| Interesi më i lartë i fëmijës .....                                                                                                                                                                      | 17 |
| Ligjshmëria.....                                                                                                                                                                                         | 18 |
| Parandalimi .....                                                                                                                                                                                        | 18 |
| Proporcionaliteti.....                                                                                                                                                                                   | 19 |
| Etika profesionale .....                                                                                                                                                                                 | 19 |
| Konfidencialiteti .....                                                                                                                                                                                  | 19 |
| Bashkëpunimi institucional.....                                                                                                                                                                          | 20 |
| Transparenca dhe llogaridhënia .....                                                                                                                                                                     | 20 |
| Mosdiskriminimi .....                                                                                                                                                                                    | 21 |
| Profesionalizmi .....                                                                                                                                                                                    | 21 |
| MISIONI DHE ROLI I OFICERIT TË SIGURISË .....                                                                                                                                                            | 22 |
| Garantimi i sigurisë në shkollë .....                                                                                                                                                                    | 22 |

|                                                                                           |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Parandalimi i dukurive negative .....                                                     | 23 |
| Mbështetja e klimës së sigurt në shkollë .....                                            | 24 |
| Ndërveprimi me komunitetin shkollor.....                                                  | 24 |
| Roli parandalues dhe jo ndëshkues.....                                                    | 25 |
| KUFIJTË E ROLIT DHE TË KOMPETENCAVE TË OFICERIT TË SIGURISË.....                          | 26 |
| Çfarë bën oficeri i sigurisë?.....                                                        | 26 |
| Çfarë nuk bën oficeri i sigurisë? .....                                                   | 27 |
| Kufijtë e rolit në raport me drejtorinë e institucionit arsimor .....                     | 28 |
| Kufijtë e rolit në raport me psikologun e shkollës .....                                  | 28 |
| Kufijtë e rolit në raport me punonjësin social .....                                      | 29 |
| Kufijtë e rolit në raport me mësuesin .....                                               | 30 |
| Kufijtë e rolit në raport me Policinë e Shtetit .....                                     | 30 |
| PROFILI PROFESIONAL I OFICERIT TË SIGURISË .....                                          | 32 |
| Vlerat profesionale .....                                                                 | 32 |
| Kompetencat profesionale .....                                                            | 35 |
| STANDARDET PROFESIONALE TË OFICERËVE TË SIGURISË NË SHKOLLA .....                         | 39 |
| Struktura dhe ndërtimi i standardeve profesionale të oficerit të sigurisë .....           | 39 |
| Standardi 1: Planifikimi, organizimi i punës, dokumentimi dhe raportimi profesional ..... | 41 |
| Standardi 2: Siguria fizike dhe monitorimi i mjedisit shkollor .....                      | 44 |
| Standardi 3: Përdorimi i teknologjisë dhe siguria e informacionit.....                    | 46 |
| Standardi 4: Menaxhimi i situatave problematike dhe emergjente .....                      | 48 |
| Standardi 5: Parandalimi i dhunës dhe i dukurive negative .....                           | 50 |
| Standardi 6: Edukimi dhe ndërgjegjësimi për sigurinë.....                                 | 52 |
| Standardi 7: Zhvillimi i vazhdueshëm dhe rritja profesionale .....                        | 54 |
| Standardi 8: Etika dhe integriteti profesional.....                                       | 56 |
| Standardi 9: Komunikimi dhe ndërveprimi me nxënësit.....                                  | 58 |
| Standardi 10: Bashkëpunimi institucional dhe ndërinstitutional.....                       | 60 |
| Standardi 11: Referimi dhe menaxhimi i rasteve .....                                      | 62 |
| TERMAT KRYESORE .....                                                                     | 64 |
| BAZA LIGJORE .....                                                                        | 66 |
| REFERENCAT .....                                                                          | 69 |

# HYRJE

Standardet profesionale të oficerit të sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare, përbëjnë një kuadër të strukturuar kompetencash, përgjegjësish dhe kërkesash profesionale, që orientojnë ushtrimin e detyrës së oficerit të sigurisë në shkollë. Këto standarde synojnë të garantojnë funksionimin efektiv të rolit të oficerit të sigurisë në mbrojtjen e jetës, të shëndetit dhe të mirëqenies së nxënësve, të stafit arsimor dhe të komunitetit shkollor, si dhe në krijimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës për procesin edukativ.

Roli i oficerit të sigurisë në shkollë, ka marrë rëndësi të veçantë në kushtet e rritjes së nevojës për parandalimin e dhunës, menaxhimin e konflikteve, identifikimin e hershëm të riskut dhe forcimin e bashkëpunimit institucional me strukturat ligjzbatuese. Në këtë kuadër, standardet profesionale shërbejnë si instrument orientues për përcaktimin e pritshmërive profesionale, organizimin e punës, monitorimin e performancës dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar nga oficeri i sigurisë.

Këto standarde mbështeten në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar, mbrojtjen e fëmijëve, sigurinë publike dhe të drejtat e njeriut, si dhe në parimet e etikës profesionale, të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të respektimit të interesit më të lartë të fëmijës. Ato synojnë të forcojnë rolin e oficerit të sigurisë jo vetëm si strukturë kontrolli dhe reagimi ndaj incidenteve, por edhe si aktor aktiv në promovimin e kulturës së sigurisë, të edukimit qytetar, të parandalimit të sjelljeve me risk dhe të ndërtimit të marrëdhënieve pozitive në komunitetin shkollor.

Zbatimi i standardeve profesionale ndihmon në unifikimin e praktikave të punës, rritjen e profesionalizmit, forcimin e bashkëpunimit me strukturat e shkollës dhe institucionet partnere, si dhe në garantimin e një qasjeje të qëndrueshme dhe efektive për sigurinë dhe mbrojtjen e nxënësve në mjedisin shkollor.

## Qëllimi i standardeve

Standardet profesionale të oficerit të sigurisë në shkollë, synojnë të krijojnë një kuadër të unifikuar profesional për organizimin, funksionimin, monitorimin dhe vlerësimin e praktikës së punës së oficerëve të sigurisë, në institucionet arsimore parauniversitare. Këto standarde shërbejnë si dokument orientues dhe rregullator për përcaktimin e roleve, të kompetencave, të përgjegjësive, të kufijve profesionalë dhe të pritshmërive të performancës së oficerit të sigurisë në shkollë.

Hartimi i standardeve mbështetet në nevojën për të garantuar një qasje të përbashkët dhe të qëndrueshme të funksionimit të këtij shërbimi, në të gjitha institucionet arsimore parauniversitare, duke shmangur interpretimet e ndryshme të rolit dhe të praktikës së punës së oficerit të sigurisë.

Përmes këtij dokumenti synohet që siguria në shkollë, të mos trajtohet si ndërhyrje sporadike apo thjesht si reagim ndaj incidenteve, por si një proces i organizuar, i vazhdueshëm dhe i mbështetur në parandalim, bashkëpunim institucional dhe dokumentim profesional.

Standardet profesionale synojnë:

- orientimin e praktikës së përditshme të punës së oficerit të sigurisë;
- qartësimin e kufijve të rolit dhe të kompetencave të tij funksionale;
- unifikimin e procedurave të punës dhe të praktikave të dokumentimit;
- mbështetjen e proceseve të monitorimit dhe të reflektimit mbi ecurinë e shërbimit;
- forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me të gjithë partnerët;
- garantimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve dhe të standardeve etike të profesionit;
- krijimin e një mjedisi të sigurt, mbështetës dhe gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit.

Këto standarde janë ndërtuar mbi praktikën ekzistuese të funksionimit të oficerëve të sigurisë në shkolla, mbi dokumentet orientuese të praktikës së punës, instrumentet e raportimit dhe të vlerësimit, si dhe mbi përvojën e fituar nga procesi i pilotimit dhe i shtrirjes së këtij shërbimi në nivel kombëtar.

## Rëndësia e standardeve

Siguria në institucionet arsimore është element themelor për garantimin e zhvillimit normal të procesit mësimor, për mbrojtjen e mirëqenies fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve. Vitet e fundit, institucionet arsimore parauniversitare janë përballur me sfida të ndryshme, që lidhen me:

- dhunën ndërmjet nxënësve;
- bullizmin dhe cyberbullizmin;
- përdorimin e substancave narkotike;
- cenimin e sigurisë fizike në shkollë;
- hyrjen e personave të paautorizuar;
- konfliktet sociale dhe problematikat e sjelljes;
- situatat emergjente dhe krizat në komunitetin shkollor.

Përballë këtyre sfidave, krijimi i figurës së oficerit të sigurisë në shkolla, është konceptuar si një mekanizëm mbështetës dhe parandalues për rritjen e sigurisë në institucionet arsimore.

Rëndësia e këtyre standardeve lidhet me nevojën për:

- ndërtimin e një sistemi profesional sigurie në shkolla;
- garantimin e një praktike të unifikuar pune;
- rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar;
- përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve institucionalë;
- forcimin e dokumentimit dhe të gjurmueshmërisë së veprimeve;
- rritjen e llogaridhënies dhe të profesionalizmit.

Standardet krijojnë një bazë të qartë për mënyrën se si oficeri i sigurisë duhet të ushtrojë detyrën, si duhet të bashkëpunojë me strukturat e tjera të shkollës dhe si duhet të reagojë në situata problematike apo emergjente.

Gjithashtu, standardet ndihmojnë në:

- mbrojtjen e nxënësve dhe të stafit të shkollës;
- krijimin e një klime të sigurt dhe pozitive;
- rritjen e besimit të prindërve dhe të komunitetit;
- përmirësimin e perceptimit të figurës së oficerit të sigurisë;
- forcimin e rolit parandalues të institucionit arsimor.

Përmes këtyre standardeve, synohet që oficeri i sigurisë të mos perceptohet si figurë ndëshkuese apo kontrolluese, por si pjesë mbështetëse e mekanizmit të sigurisë dhe të mbrojtjes së nxënësve në shkollë. Kjo qasje mbështetet edhe në dokumentet ekzistuese të praktikës së punës së oficerëve të sigurisë, të cilat e përcaktojnë këtë rol në funksion të ndërveprimit, të parandalimit dhe të bashkëpunimit me komunitetin shkollor.

## Fusha e zbatimit

Këto standarde zbatohen për oficerët e sigurisë, të angazhuar në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Standardet orientojnë:

- praktikën profesionale të oficerëve të sigurisë;
- procesin e monitorimit dhe të vlerësimit të performancës së tyre;
- organizimin e dokumentimit profesional;
- bashkëpunimin institucional dhe ndërinstitucional;
- planifikimin dhe zhvillimin profesional të shërbimit.

Ky dokument shërben gjithashtu, si referencë për:

- drejtuesit e institucioneve arsimore;
- strukturat përgjegjëse të DRAP/ZVAP-ve;
- Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar;
- strukturat e policimit në komunitet;
- shërbimin psiko-social;
- institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe koordinimin e shërbimit.

Standardet zbatohen në të gjitha aspektet e praktikës së punës së oficerit të sigurisë, duke përfshirë:

- sigurinë fizike të shkollës;
- parandalimin e dukurive negative;
- komunikimin dhe bashkëpunimin institucional;
- dokumentimin profesional;
- menaxhimin e situatave problematike dhe emergjente;
- ndërgjegjësimin dhe edukimin për sigurinë;
- referimin dhe koordinimin e rasteve.

# KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Funksionimi i oficerit të sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare, mbështetet në një kuadër të gjerë ligjor dhe institucional, i cili përcakton bazat e organizimit të këtij shërbimi, rolin dhe përgjegjësitë e oficerit të sigurisë, mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstitutional, si dhe standardet që lidhen me garantimin e sigurisë dhe të mirëqenies së nxënësve në mjedisin shkollor. Ky kuadër është ndërtuar mbi parimin se siguria në shkollë nuk përfaqëson vetëm mbrojtjen fizike të mjedisit arsimor, por është një proces i vazhdueshëm institucional, që lidhet me parandalimin, mbrojtjen, ndërhyrjen e hershme, bashkëpunimin dhe garantimin e një klime të sigurt dhe mbështetëse për zhvillimin e procesit mësimor.

Kuadri ligjor dhe institucional i oficerit të sigurisë është rezultat i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për arsimin dhe institucioneve përgjegjëse për sigurinë publike, duke reflektuar nevojën për një qasje të integruar në menaxhimin e sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare. Kjo qasje u zhvillua fillimisht në kuadër të projektit “Shkolla të sigurt”, i cili synonte rritjen e sigurisë në shkolla përmes ndërveprimit, parandalimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me komunitetin shkollor.

Roli i oficerit të sigurisë mbështetet në parimin e ligjshmërisë, sipas të cilit çdo veprim, procedurë, ndërhyrje apo bashkëpunim institucional duhet të zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në respektim të plotë të të drejtave dhe të lirive themelore të fëmijëve. Në ushtrimin e detyrës së tij, oficeri i sigurisë duhet të respektojë kufijtë e kompetencave profesionale dhe të veprojë në funksion të interesit më të lartë të nxënësit, duke garantuar proporcionalitet, etikë profesionale, konfidencialitet dhe bashkëpunim institucional.

## Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përbën bazën themelore juridike mbi të cilën ndërtohet mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, garantohet siguria publike dhe funksionimi i institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë. Parimet kushtetuese që lidhen me mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore, të drejtën për arsimim dhe mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë dhune apo diskriminimi, përbëjnë bazën mbi të cilën duhet të ushtrohet veprimtaria profesionale e oficerit të sigurisë në shkollë.

Veprimtaria e oficerit të sigurisë duhet të zhvillohet në përputhje me parimet kushtetuese të ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të respektimit të dinjitetit të individit. Në këtë kuadër, çdo ndërhyrje, evidentim, raportim apo procedurë që lidhet me sigurinë në shkollë, duhet të kryhet duke respektuar të drejtat e nxënësve, privatësinë e tyre dhe mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Kushtetuta garanton gjithashtu, të drejtën për arsimim në një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur, çka e bën sigurinë në institucionet arsimore një përgjegjësi institucionale dhe shoqërore. Në këtë kuptim, funksionimi i oficerit të sigurisë përfaqëson një mekanizëm institucional në mbështetje të garantimit të kësaj të drejte kushtetuese.

## **Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar**

Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përbën bazën kryesore ligjore për organizimin dhe funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj përcakton parimet e funksionimit të sistemit arsimor, organizimin institucional, të drejtat dhe detyrimet e nxënësve, përgjegjësitë e institucioneve arsimore dhe detyrimin për garantimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës për zhvillimin e procesit mësimor.

Në funksion të garantimit të sigurisë, ky ligj përcakton përgjegjësinë e institucioneve arsimore parauniversitare për mbrojtjen e nxënësve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin normal të procesit arsimor. Institucionet arsimore kanë detyrimin të bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse për sigurinë, mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijëve, si pjesë e përgjegjësisë institucionale për menaxhimin e mjedisit shkollor.

Funksionimi i oficerit të sigurisë lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësinë e shkollës për:

- garantimin e sigurisë fizike;
- parandalimin e dhunës dhe të dukurive negative;
- mbrojtjen e nxënësve nga situatat me risk;
- evidentimin dhe referimin e problematikave;
- bashkëpunimin me strukturat mbështetëse dhe institucionet përgjegjëse.

Ky ligj krijon bazën për përfshirjen e mekanizmave mbështetës në institucionet arsimore dhe për bashkëpunimin ndërinstitucional, në funksion të mbrojtjes dhe të sigurisë së nxënësve.

## **Ligji nr. 18/2017, datë 23.02.2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”**

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përbën një nga bazat më të rëndësishme ligjore, që orienton veprimtarinë e oficerit të sigurisë në shkollë. Ky ligj përcakton detyrimin e institucioneve shtetërore për garantimin e mbrojtjes së fëmijëve nga çdo formë:

- dhune;
- abuzimi;
- neglizhence;
- diskriminimi;
- shfrytëzimi;
- cenimi të mirëqenies dhe të zhvillimit të tyre.

Parimi themelor mbi të cilin mbështetet ky ligj, është interesi më i lartë i fëmijës, i cili duhet të udhëheqë çdo veprim, procedurë apo vendimmarrje që lidhet me fëmijët. Në këtë kuadër, oficeri i sigurisë duhet të zhvillojë veprimtarinë e tij profesionale, duke garantuar mbrojtjen e nxënësve, respektimin e dinjitetit të tyre dhe trajtimin me profesionalizëm të çdo situatë problematike apo emergjente.

Ky ligj orienton rolin e oficerit të sigurisë drejt:

- identifikimit të hershëm të situatave me risk;
- referimit institucional të rasteve;
- bashkëpunimit me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve;
- dokumentimit të rasteve problematike;
- mbrojtjes së konfidencialitetit dhe të privatësisë së nxënësve.

Në këtë kuadër, oficeri i sigurisë konsiderohet pjesë e mekanizmit institucional të mbrojtjes së fëmijëve në shkollë dhe duhet të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse në nivel shkolle, vendor dhe ndërinstitutional, për trajtimin e rasteve që cenojnë sigurinë apo mirëqenien e nxënësve.

## **Ligji nr. 108/2014, datë 31.07.2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar**

Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, krijon bazën për bashkëpunimin institucional ndërmjet strukturave të Policisë së Shtetit dhe institucioneve arsimore, në funksion të garantimit të sigurisë publike dhe të parandalimit të dukurive negative në mjediset shkollore.

Funksionimi i oficerit të sigurisë lidhet drejtpërdrejt me bashkëpunimin me strukturat e policimit në komunitet, veçanërisht në rastet kur identifikohen:

- situata që cenojnë sigurinë publike;
- elementë kriminalë;
- përdorim apo shpërndarje të substancave narkotike;
- mbajtje të mjeteve të rrezikshme;
- konflikte me risk të lartë;
- cenim i territorit dhe i sigurisë së shkollës.

Megjithatë, ky kuadër ligjor nuk e përcakton oficerin e sigurisë si strukturë policore apo ligjzbatuese. Oficeri i sigurisë nuk ushtron kompetenca të Policisë së Shtetit dhe nuk zëvendëson strukturat e saj. Ai nuk kryen procedura hetimore, masa ndëshkuese, kontrolle apo veprime procedurale, që janë kompetencë ekskluzive e organeve ligjzbatuese.

Roli i oficerit të sigurisë mbetet rol parandalues, monitorues, bashkëpunues dhe mbështetës në institucionin arsimor, ndërsa bashkëpunimi me Policinë e Shtetit realizohet në funksion të koordinimit institucional dhe të garantimit të sigurisë në shkollë dhe përreth saj.

## **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 9.10.2018, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”**

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 9.10.2018, përbën aktin kryesor nënligjor, që rregullon krijimin, organizimin dhe funksionimin e shërbimit të oficerëve të sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare publike.

Ky vendim përcakton se shërbimi i sigurisë publike në institucionet arsimore parauniversitare, konsiston në monitorimin nga oficeri i sigurisë të ndërveprimit të vazhdueshëm ndërmjet nxënësve, personelit mësimor dhe komunitetit, me qëllim garantimin e një mjedisi të sigurt në shkollë dhe përreth saj. Vendimi përcakton gjithashtu, objektivat kryesorë të këtij shërbimi, të cilat lidhen me:

- përmirësimin e sigurisë faktike dhe të perceptuar në shkollë;
- garantimin e sigurisë së nxënësve;
- parandalimin e dukurive negative;
- forcimin e bashkëpunimit me strukturat e policimit në komunitet;
- përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet nxënësve dhe strukturave të sigurisë.

VKM-ja përcakton gjithashtu, kriteret profesionale që duhet të plotësojnë kandidatët për oficer sigurie, duke e konceptuar këtë funksion si pozicion profesional të specializuar, që kërkon formim universitar, integritet profesional dhe aftësi bashkëpunuese e komunikuese.

Ky vendim përbën bazën institucionale për organizimin e këtij shërbimi në institucionet arsimore dhe orienton funksionimin e oficerit të sigurisë drejt parandalimit, ndërveprimit dhe bashkëpunimit institucional dhe jo drejt një qasjeje policore apo ndëshkuese në shkollë.

## **Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”**

Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare përbën një dokument të rëndësishëm institucional, për përcaktimin e mënyrës së organizimit, të funksionimit dhe të administrimit të shkollës. Ajo orienton veprimtarinë e përditshme të institucionit arsimor, marrëdhëniet ndërmjet aktorëve të shkollës, përcakton përgjegjësitë e drejtuesve, të mësuesve, të nxënësve, të prindërve dhe të strukturave mbështetëse, si dhe mënyrën se si shkolla duhet të garantojë një mjedis të rregullt, të sigurt dhe funksional për zhvillimin e procesit mësimor.

Në raport me standardet profesionale të oficerit të sigurisë, kjo rregullore ka rëndësi të veçantë, sepse e vendos punën e tij brenda organizimit të përgjithshëm të institucionit arsimor. Oficeri i sigurisë nuk vepron i shkëputur nga struktura e shkollës, por në bashkëpunim me drejtuesin e institucionit, stafin pedagogjik, shërbimin psiko-social dhe aktorët e tjerë të komunitetit shkollor.

Për këtë arsye, çdo veprim i tij duhet të jetë në përputhje me rregullat e brendshme të institucionit arsimor, me procedurat administrative dhe me përgjegjësitë që lidhen me ruajtjen e rendit, të sigurisë, të etikës dhe të klimës pozitive në mjedisin arsimor.

Rregullorja ndihmon gjithashtu, në përcaktimin e kufijve të rolit të oficerit të sigurisë. Duke qenë se institucioni arsimor ka strukturat e veta drejtuese, pedagogjike dhe mbështetëse, oficeri i sigurisë duhet të ushtrojë funksionin e tij, pa zëvendësuar rolin e drejtorit, të mësuesit, të psikologut, të punonjësit social apo të organeve të tjera të shkollës. Roli i tij lidhet me evidentimin, parandalimin, raportimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen për garantimin e sigurisë, ndërsa vendimmarrja pedagogjike, disiplinore apo psiko-sociale mbetet në përgjegjësinë e strukturave përkatëse të institucionit.

Në këtë kuptim, “Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare” shërben si bazë orientuese për harmonizimin e punës së oficerit të sigurisë me jetën institucionale të shkollës. Ajo e ndihmon këtë rol, të mos konceptohet si një strukturë paralele, por si pjesë mbështetëse e funksionimit të rregullt të institucionit arsimor, në shërbim të sigurisë së nxënësve dhe të mbarëvajtjes së procesit edukativ.

## **“Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Oficerëve të Sigurisë”**

“Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Oficerëve të Sigurisë” është dokumenti më i drejtpërdrejtë orientues për mënyrën se si oficeri i sigurisë duhet të organizojë, duhet të dokumentojë dhe duhet zhvillojë praktikën e tij profesionale në institucionin arsimor. Ai është hartuar nga ASCAP-i në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe përmbledh praktikën, rutinën, formatet e raportimit, instrumentet e dokumentimit dhe mekanizmat e punës që ndihmojnë oficerin e sigurisë në ushtrimin e detyrës.

Ky udhëzues ka rëndësi themelore për ndërtimin e standardeve profesionale, sepse kalon nga përcaktimet e përgjithshme ligjore në praktikën konkrete të punës. Ai përfshin elemente, të tilla si planifikimi vjetor, plani i sigurisë së shkollës, raporti i incidenteve, raporti javor, raporti vjetor, memo, procesverbal, formulari i sinjalizimit të hershëm, formulari për referimin e rasteve, plani i masave, formatet për realizimin e veprimtarive dhe instrumentet matëse.

Në raport me standardet profesionale, ky dokument shërben si burim kryesor për përcaktimin e treguesve të performancës dhe të evidencave të verifikimit. Standardet nuk duhet të mbeten vetëm në nivel deklarativ, por duhet të lidhen me veprime konkrete të dokumentueshme.

Për shembull, nëse standardi lidhet me parandalimin e dukurive negative, atëherë evidencë për zbatimin e tij mund të jetë formulari i sinjalizimit të hershëm, raporti i incidentit, plani i masave ose raporti javor. Nëse standardi lidhet me bashkëpunimin institucional, evidencë mund të jenë procesverbalet, memot, raportet e takimeve dhe formularët e referimit.

Udhëzuesi e vendos oficerin e sigurisë në një qasje të qartë parandaluese dhe bashkëpunuese. Ai e lidh punën e oficerit të sigurisë me monitorimin e mjediseve brenda dhe përreth shkollës, evidentimin e situatave problematike, raportimin pranë strukturave përkatëse, bashkëpunimin me shërbimin psiko-social dhe ndërmjetësimin e situatave konfliktuale brenda kufijve të rolit. Gjithashtu, udhëzuesi thekson se oficeri i sigurisë nuk ndërmerr masa disiplinore në shkollë dhe nuk zhvillon kontrolle fizike apo të mjediseve, përveç rasteve të përcaktuara sipas vendimmarrjes dhe procedurave institucionale.

Për këtë arsye, “Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Oficerëve të Sigurisë” duhet të përdoret si dokument bazë për vënien në zbatim të standardeve profesionale. Ai siguron lidhjen ndërmjet kuadrit ligjor, detyrave funksionale dhe praktikës së përditshme të punës, duke mundësuar që çdo standard të shoqërohet me tregues të matshëm, mjete dokumentimi dhe procedura të qarta verifikimi.

# PARIMET THEMELORE TË PUNËS SË OFICERIT TË SIGURISË

Veprimtaria profesionale e oficerit të sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare, mbështetet në një tërësi parimesh themelore, që orientojnë mënyrën e ushtrimit të detyrës, sjelljen profesionale, marrëdhëniet me komunitetin shkollor dhe mënyrën e menaxhimit të situatave që lidhen me sigurinë në shkollë. Këto parime përbëjnë bazën etike, profesionale dhe institucionale të funksionimit të oficerit të sigurisë dhe shërbejnë si orientim për çdo veprim, vendimmarrje, ndërhyrje, raportim apo bashkëpunim institucional të zhvilluar në kuadër të ushtrimit të detyrës.

Për shkak të natyrës së ndjeshme të këtij funksioni dhe të ndërveprimit të vazhdueshëm me nxënësit, stafin pedagogjik, prindërit dhe strukturat e tjera institucionale, respektimi i këtyre parimeve është thelbësor për garantimin e një praktike profesionale të përgjegjshme, etike dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

## Interesi më i lartë i fëmijës

Interesi më i lartë i fëmijës përbën parimin themelor mbi të cilin duhet të mbështetet çdo veprim dhe vendimmarrje e oficerit të sigurisë në shkollë. Në ushtrimin e detyrës, oficeri i sigurisë duhet të ketë në fokus mbrojtjen e sigurisë, të mirëqenies, të dinjitetit dhe të zhvillimit të nxënësve, duke garantuar që çdo ndërhyrje, procedurë apo masë e ndërmarrë, të jetë në funksion të mbrojtjes së interesit të tyre më të mirë.

Ky parim kërkon që oficeri i sigurisë të tregojë ndjeshmëri profesionale ndaj problematikave që lidhen me nxënësit dhe të shmangë çdo veprim që mund të cenojë mirëqenien emocionale, psikologjike apo sociale të tyre. Në situata problematike apo konfliktuale, ai duhet të ruajë qasje parandaluese, mbështetëse dhe mbrojtëse, duke shmangur etiketimin, stigmatizimin apo ekspozimin e nxënësve.

Interesi më i lartë i fëmijës lidhet gjithashtu, me detyrimin për të evidentuar, për të raportuar dhe për të referuar çdo situatë, që mund të cenojë sigurinë, zhvillimin apo mirëqenien e nxënësit, duke bashkëpunuar me strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe institucionet e tjera mbështetëse.

## Ligjshmëria

Parimi i ligjshmërisë kërkon që oficeri i sigurisë të ushtrojë funksionin e tij, në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore që rregullojnë funksionimin e këtij shërbimi. Çdo veprim, procedurë, raportim apo bashkëpunim institucional, duhet të zhvillohet në respektim të kuadrit ligjor dhe të kufijve të kompetencave profesionale të përcaktuara për këtë funksion.

Në ushtrimin e detyrës së tij, oficeri i sigurisë duhet të jetë i vetëdijshëm për kufijtë e rolit dhe të përgjegjësitë të tij dhe të shmangë ushtrimin e kompetencave që u përkasin strukturave të tjera institucionale, si organet ligjzbatuese, strukturat disiplinore të shkollës apo specialistët e shërbimit psiko-social.

Parimi i ligjshmërisë lidhet gjithashtu, me respektimin e të drejtave të nxënësve, mbrojtjen e të dhënave personale, ruajtjen e konfidencialitetit dhe dokumentimin korrekt të çdo veprimtarie profesionale të zhvilluar në kuadër të ushtrimit të detyrës.

## Parandalimi

Parandalimi përbën një nga parimet kryesore mbi të cilat mbështetet funksionimi i oficerit të sigurisë në shkollë. Roli i tij nuk lidhet vetëm me reagimin ndaj incidenteve apo situatave problematike, por mbi të gjitha me evidentimin e hershëm të faktorëve të riskut dhe ndërmarrjen e veprimeve parandaluese për shmangien e përshkallëzimit të tyre.

Në këtë kuadër, oficeri i sigurisë duhet të zhvillojë praktikë të vazhdueshme monitorimi, komunikimi dhe bashkëpunimi me komunitetin shkollor, me qëllim identifikimin e hershëm të problematikave që mund të cenojnë sigurinë në shkollë.

Kjo përfshin evidentimin e konflikteve ndërmjet nxënësve, të sjelljeve problematike, të rasteve të bullizmit, të përdorimit të substancave të dëmshme, të cenimit të sigurisë fizike dhe të çdo shtate tjetër që mund të ndikojë negativisht në klimën e institucionit arsimor.

Parimi i parandalimit kërkon ndërtimin e marrëdhënieve të besimit me nxënësit dhe stafin pedagogjik, në mënyrë që problematikat të evidentohen dhe të trajtohen në fazat e hershme të shfaqjes së tyre.

## Proporcionaliteti

Parimi i proporcionalitetit kërkon që çdo ndërhyrje, reagim apo masë e ndërmarrë nga oficeri i sigurisë, të jetë në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe nivelin e situatës së evidentuar. Në ushtrimin e detyrës së tij, oficeri i sigurisë duhet të shmangë reagimet e tepruara, ndërhyrjet e panevojshme apo sjelljet që mund të krijojnë tension, frikë apo cenim të dinjitetit të nxënësve.

Në situatat problematike, oficeri i sigurisë duhet të analizojë me kujdes kontekstin, nivelin e riskut dhe nevojën reale për ndërhyrje, duke privilegjuar gjithmonë komunikimin, ndërmjetësimin dhe zgjidhjen parandaluese të situatave, përpara ndërhyrjeve më formale apo referimeve institucionale.

Parimi i proporcionalitetit lidhet gjithashtu, me respektimin e kufijve të kompetencave profesionale dhe me shmangien e çdo forme ndërhyrjeje, që mund të perceptohet si presion, intimidim apo trajtim jo proporcional ndaj nxënësve.

## Etika profesionale

Etika profesionale përbën bazën e sjelljes dhe të praktikës profesionale të oficerit të sigurisë në shkollë. Për shkak të natyrës së ndjeshme të funksionit të tij dhe të ndërveprimit të vazhdueshëm me fëmijët dhe komunitetin shkollor, oficeri i sigurisë duhet të karakterizohet nga integriteti moral, korrektesia, vetëkontrolli dhe ndershmëria profesionale.

Në ushtrimin e detyrës së tij, ai duhet të tregojë respekt ndaj nxënësve, stafit pedagogjik dhe prindërve, duke shmangur çdo sjellje paragjyquese, diskriminuese apo denigruese. Etika profesionale kërkon gjithashtu, që oficeri i sigurisë të ruajë paanshmërinë në trajtimin e situatave dhe të mos ndikojë nga preferenca personale, paragjykimet apo interesat e jashtme.

Sjellja profesionale e oficerit të sigurisë duhet të kontribuojë në krijimin e një klime besimi dhe sigurie në institucionin arsimor dhe në forcimin e figurës së tij si rol mbështetës dhe bashkëpunues në shkollë.

## Konfidencialiteti

Në ushtrimin e detyrës së tij, oficeri i sigurisë mund të ketë akses në informacione sensitive, që lidhen me nxënësit, familjet e tyre apo situata problematike të evidentuara në shkollë. Për këtë arsye, ruajtja e konfidencialitetit përbën një nga parimet themelore të praktikës së tij profesionale.

Çdo informacion i marrë gjatë ushtrimit të detyrës, duhet të trajtohet me diskrecion dhe të përdoret vetëm në funksion të garantimit të sigurisë dhe të mbrojtjes së nxënësve. Oficeri i sigurisë duhet të shmangë shpërndarjen e informacionit të persona të paautorizuar dhe të respektojë procedurat institucionale për dokumentimin, ruajtjen dhe administrimin e të dhënave.

Respektimi i konfidencialitetit është element thelbësor për ruajtjen e besimit të nxënësve, të prindërve dhe të komunitetit shkollor, ndaj figurës së oficerit të sigurisë dhe ndaj institucionit arsimor në tërësi.

## **Bashkëpunimi institucional**

Siguria në shkollë nuk mund të garantohet nga një strukturë e vetme, por kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në jetën institucionale të shkollës. Për këtë arsye, bashkëpunimi institucional përbën një nga parimet themelore të punës së oficerit të sigurisë.

Në ushtrimin e detyrës së tij, oficeri i sigurisë duhet të bashkëpunojë me drejtuesin e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, shërbimin psiko-social, prindërit, strukturat e policimit në komunitet dhe institucionet e tjera përgjegjëse për mbrojtjen dhe mirëqenien e nxënësve.

Ky bashkëpunim duhet të mbështetet në komunikim profesional, koordinim institucional dhe respektim të roleve dhe të përgjegjësive të secilit aktor, duke shmangur mbivendosjen e kompetencave dhe konfliktet institucionale.

## **Transparenca dhe llogaridhënia**

Parimi i transparencës dhe i llogaridhënies kërkon që oficeri i sigurisë të zhvillojë praktikën e tij profesionale në mënyrë të dokumentuar, të verifikueshme dhe në përputhje me procedurat institucionale të raportimit dhe të monitorimit.

Çdo veprimtari profesionale, incident, situatë problematike apo ndërhyrje, duhet të evidentohet dhe duhet të dokumentohet sipas formateve dhe instrumenteve të përcaktuara nga kuadri institucional i funksionimit të shërbimit. Dokumentimi korrekt i praktikës së punës, garanton gjurmueshmëri, monitorim dhe vlerësim të veprimtarisë së oficerit të sigurisë.

Llogaridhënia lidhet gjithashtu, me përgjegjësinë profesionale të oficerit të sigurisë për mënyrën se si ushtron detyrën, ndërvepron me institucionet dhe menaxhon situatat që lidhen me sigurinë në shkollë.

## Mosdiskriminimi

Oficeri i sigurisë duhet të trajtojë çdo nxënës dhe çdo anëtar të komunitetit shkollor me barazi, respekt dhe paanshmëri, pa ushtruar diskriminim për shkak të gjinisë, të origjinës, të aftësisë së kufizuar, të besimit fetar, të statusit social, të përkatësisë etnike apo të çdo karakteristike tjetër personale.

Parimi i mosdiskriminimit kërkon që oficeri i sigurisë të shmangë çdo formë stigmatizimi, etiketimi apo trajtimi të diferencuar ndaj nxënësve dhe të kontribuojë në krijimin e një klime gjithëpërfshirëse dhe të sigurt në institucionin arsimor.

Në ushtrimin e detyrës së tij, ai duhet të tregojë ndjeshmëri profesionale ndaj diversitetit dhe të respektojë dinjitetin dhe individualitetin e çdo nxënësi.

## Profesionalizmi

Profesionalizmi përbën një element thelbësor të funksionimit të rolit të oficerit të sigurisë dhe lidhet me mënyrën se si ai ushtron detyrën, komunikon me komunitetin shkollor dhe përfaqëson institucionin brenda mjedisit arsimor.

Oficeri i sigurisë duhet të tregojë korrektësi, seriozitet, përgjegjshmëri dhe përkushtim në ushtrimin e funksionit të tij, duke respektuar standardet profesionale dhe etike të shërbimit. Ai duhet të jetë i aftë të menaxhojë situatat problematike me qetësi, objektivitet dhe vetëkontroll, duke ruajtur integritetin profesional dhe paanshmërinë në trajtimin e rasteve.

Profesionalizmi lidhet me aftësinë për të dokumentuar korrekt praktikën e punës, për të bashkëpunuar në mënyrë efektive me strukturat institucionale dhe për të zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme kompetencat profesionale të nevojshme për ushtrimin e detyrës.

# MISIONI DHE ROLI I OFICERIT TË SIGURISË

Oficeri i sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare, është një figurë profesionale me rol mbështetës, parandalues dhe bashkëpunues, në funksion të garantimit të sigurisë dhe të mirëqenies së komunitetit shkollor. Misioni i tij lidhet me krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi të sigurt fizikisht, emocionalisht dhe social për nxënësit, stafin pedagogjik dhe çdo individ të përfshirë në jetën institucionale të shkollës.

Funksionimi i rolit të oficerit të sigurisë mbështetet në konceptin e sigurisë parandaluese dhe komunitare në shkollë, ku siguria nuk kuptohet vetëm si kontroll fizik i mjedisit apo reagim ndaj incidenteve, por si një proces i vazhdueshëm monitorimi, bashkëpunimi, komunikimi dhe ndërhyrjeje të hershme, në funksion të mbrojtjes së nxënësve dhe të parandalimit të situatave që cenojnë klimën e institucionit arsimor.

Roli i oficerit të sigurisë është ndërtuar mbi nevojën për të krijuar një figurë profesionale, që ndërvepron çdo ditë me nxënësit dhe komunitetin shkollor, duke kontribuar në evidentimin e hershëm të problematikave, rritjen e sigurisë në shkollë dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional. Ky rol nuk është konceptuar si funksion policor apo disiplinor brenda shkollës, por si një mekanizëm mbështetës dhe bashkëpunues në funksion të sigurisë dhe të mirëqenies së nxënësve.

## Garantimi i sigurisë në shkollë

Garantimi i sigurisë në institucionin arsimor përbën misionin kryesor të oficerit të sigurisë. Në këtë kuadër, ai kontribuon në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të mbrojtur për zhvillimin normal të procesit mësimor dhe jetës institucionale të shkollës.

Siguria në shkollë lidhet jo vetëm me mbrojtjen fizike të mjedisit arsimor, por edhe me garantimin e një klime të qetë, të rregullt dhe mbështetëse për nxënësit dhe stafin pedagogjik. Për këtë arsye, oficeri i sigurisë zhvillon një praktikë të vazhdueshme monitorimi dhe evidentimi të situatave që mund të cenojnë sigurinë në shkollë dhe në territorin përreth saj.

Në ushtrimin e detyrës së tij, oficeri i sigurisë monitoron mjediset e brendshme dhe të jashtme të institucionit arsimor, evidenton situatat problematike që lidhen me sigurinë dhe koordinohet me drejtuesin e institucionit, stafin pedagogjik dhe strukturat e tjera përgjegjëse për minimizimin e risqeve dhe menaxhimin e problematikave të evidentuara.

Garantimi i sigurisë përfshin gjithashtu evidentimin e:

- hyrjes së personave të paautorizuar në shkollë;
- situatave konfliktuale;
- rreziqeve fizike në mjediset e institucionit;
- cenimit të territorit të shkollës;
- problematikave që lidhen me përdorimin e substancave të dëmshme;
- sjelljeve që mund të cenojnë sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve.

Në këtë kuadër, oficeri i sigurisë kontribuon në krijimin e një mjedisi ku nxënësit ndihen të mbrojtur, të sigurt dhe të mbështetur gjatë qëndrimit të tyre në institucionin arsimor.

## Parandalimi i dukurive negative

Parandalimi i dukurive negative përbën një nga funksionet më të rëndësishme të oficerit të sigurisë në shkollë. Roli i tij nuk kufizohet vetëm në reagimin ndaj incidenteve të ndodhura, por mbi të gjitha në identifikimin e hershëm të faktorëve të riskut dhe ndërmarrjen e veprimeve parandaluese për shmangien e përshkallëzimit të problematikave.

Në këtë kuadër, oficeri i sigurisë kontribuon në evidentimin dhe parandalimin e:

- episodeve të dhunës;
- bullizmit dhe të cyberbullizmit;
- përdorimit apo të shpërndarjes së substancave narkotike;
- sjelljeve problematike;
- konflikteve ndërmjet nxënësve;
- cenimit të sigurisë në mjediset shkollore;
- situatave me risk social apo komunitar.

Parandalimi realizohet nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të klimës së shkollës, komunikimit me nxënësit, bashkëpunimit me stafin pedagogjik dhe evidentimit të hershëm të situatave problematike. Në ushtrimin e këtij funksioni, oficeri i sigurisë duhet të tregojë aftësi vëzhguese, komunikim profesional dhe ndjeshmëri ndaj problematikave që mund të ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve.

Përmes ndërhyrjes së hershme dhe bashkëpunimit institucional, oficeri i sigurisë kontribuon në minimizimin e faktorëve të riskut dhe në krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe më të qëndrueshëm për komunitetin shkollor.

## Mbështetja e klimës së sigurt në shkollë

Një nga elementet më të rëndësishme të rolit të oficerit të sigurisë, është kontributi në krijimin dhe ruajtjen e një klime të sigurt, pozitive dhe mbështetëse në institucionin arsimor. Klima e shkollës lidhet me mënyrën se si nxënësit perceptojnë sigurinë, marrëdhëniet ndërpersonale, mbështetjen institucionale dhe ndjenjën e përkatësisë brenda komunitetit shkollor.

Oficeri i sigurisë kontribuon në ndërtimin e kësaj klime përmes:

- komunikimit korrekt dhe profesional me nxënësit;
- ndërveprimit pozitiv me komunitetin shkollor;
- menaxhimit të situatave konfliktuale;
- evidentimit të problematikave që cenojnë klimën e shkollës;
- mbështetjes së aktiviteteve parandaluese dhe ndërgjegjëse.

Prania e oficerit të sigurisë në institucionin arsimor, duhet të kontribuojë në rritjen e ndjenjës së sigurisë të nxënësit dhe stafi pedagogjik. Për këtë arsye, ai duhet të ndërtojë marrëdhënie të bazuara në respekt, komunikim dhe besim me komunitetin shkollor, duke shmangur sjelljet autoritare, intimiduese apo ndëshkuese.

Mbështetja e klimës së sigurt lidhet gjithashtu, me aftësinë e oficerit të sigurisë për të bashkëpunuar me strukturat e shkollës dhe për të kontribuar në krijimin e një mjedisi ku nxënësit ndihen të respektuar, të mbrojtur dhe të dëgjuar.

## Ndërveprimi me komunitetin shkollor

Roli i oficerit të sigurisë mbështetet në ndërveprimin e vazhdueshëm me komunitetin shkollor dhe në ndërtimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me të gjithë aktorët e përfshirë në jetën institucionale të shkollës.

Në ushtrimin e detyrës së tij, oficeri i sigurisë bashkëpunon me:

- drejtuesin e institucionit arsimor;
- stafin pedagogjik;
- shërbimin psiko-social;
- nxënësit;
- prindërit;
- strukturat e policimit në komunitet;
- institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.

Ky bashkëpunim ka rëndësi të veçantë për evidentimin e hershëm të problematikave, për koordinimin institucional dhe ndërtimin e një qasjeje të përbashkët në funksion të sigurisë në shkollë.

Oficeri i sigurisë duhet të jetë i aftë të ndërtojë marrëdhënie profesionale dhe të besueshme me nxënësit dhe komunitetin shkollor, duke krijuar mundësi për komunikim të hapur dhe bashkëpunim në trajtimin e problematikave që lidhen me sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve.

Ndërveprimi me komunitetin shkollor nuk duhet të bazohet në kontroll apo autoritet formal, por në bashkëpunim, mbështetje dhe ndërtim të besimit reciprok ndërmjet oficerit të sigurisë dhe komunitetit të shkollës.

## **Roli parandalues dhe jo ndëshkues**

Funksioni i oficerit të sigurisë në shkollë është parandalues, mbështetës dhe bashkëpunues dhe nuk duhet të konceptohet si rol ndëshkues apo policor brenda institucionit arsimor.

Oficeri i sigurisë nuk zëvendëson strukturat disiplinore të shkollës dhe nuk ushtron kompetenca të Policisë së Shtetit. Ai nuk ndërmerr masa disiplinore ndaj nxënësve dhe nuk zhvillon procedura ndëshkuese apo hetimore në institucionin arsimor.

Roli i tij lidhet me:

- evidentimin e problematikave;
- monitorimin e situatave me risk;
- raportimin institucional;
- ndërhyrjen e hershme;
- bashkëpunimin me strukturat përgjegjëse;
- mbështetjen e klimës së sigurt në shkollë.

Në këtë kuadër, oficeri i sigurisë duhet të shmangë sjelljet autoritare, intimidimin, përdorimin e gjuhës kërcënuese apo çdo formë ndërhyrjeje që mund të krijojë perceptimin e një funksioni ndëshkues brenda shkollës.

Qasja parandaluese dhe bashkëpunuese është elementi që e diferencon oficerin e sigurisë nga strukturat ligjzbatuese dhe që e vendos atë si figurë mbështetëse në komunitetin shkollor, në funksion të sigurisë, të mbrojtjes dhe të mirëqenies së nxënësve.

# KUFIJTË E ROLIT DHE TË KOMPETENCAVE TË OFICERIT TË SIGURISË

Përcaktimi i qartë i kufijve të rolit dhe të kompetencave të oficerit të sigurisë, përbën një element thelbësor për funksionimin korrekt të këtij shërbimi në institucionet arsimore parauniversitare. Për shkak të natyrës ndërdisiplinore të sigurisë në shkollë dhe ndërveprimit të vazhdueshëm me aktorë të ndryshëm institucionalë, ekziston nevoja që roli i oficerit të sigurisë të kuptohet dhe të ushtrohet brenda kufijve të përcaktuar nga kuadri ligjor, institucional dhe profesional.

Kufijtë e rolit dhe të kompetencave të oficerit të sigurisë janë të rëndësishëm për të shmangur:

- mbivendosjen e kompetencave me strukturat e tjera të shkollës;
- tejkalimin e kompetencave profesionale;
- krijimin e praktikave jo të përshtatshme institucionale;
- cenimin e të drejtave të nxënësve;
- perceptimin e gabuar të rolit të oficerit të sigurisë si figurë ndëshkuese apo policore në shkollë.

Roli i oficerit të sigurisë është konceptuar si parandalues, monitorues, mbështetës dhe bashkëpunues, në funksion të garantimit të sigurisë në institucionin arsimor. Ai nuk është strukturë disiplinore, nuk ushtron kompetenca policore dhe nuk zëvendëson funksionet pedagogjike, psiko-sociale apo administrative të institucioneve arsimore.

Për këtë arsye, është e nevojshme që kufijtë e rolit dhe të kompetencave të oficerit të sigurisë të kuptohen qartë nga vetë oficeri i sigurisë, drejtuesit e institucioneve arsimore, stafi pedagogjik dhe komuniteti shkollor.

## Çfarë bën oficeri i sigurisë?

Oficeri i sigurisë ushtron funksionin e tij në drejtim të garantimit të sigurisë dhe të mbështetjes së klimës së sigurt në institucionin arsimor.

Në ushtrimin e detyrës së tij, ai monitoron mjediset brenda dhe përreth shkollës, evidenton situatat që mund të cenojnë sigurinë dhe bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për trajtimin dhe menaxhimin e problematikave të evidentuara.

Funksioni i oficerit të sigurisë lidhet me:

- monitorimin e vazhdueshëm të sigurisë në mjediset shkollore;
- evidentimin e situatave problematike dhe të faktorëve të riskut;
- raportimin institucional të incidenteve dhe të problematikave;
- bashkëpunimin me drejtuesin e institucionit arsimor dhe stafin pedagogjik;
- bashkëpunimin me shërbimin psiko-social dhe strukturat mbështetëse;
- referimin e rasteve pranë institucioneve përgjegjëse;
- mbështetjen e ndërhyrjeve parandaluese;
- pjesëmarrjen në aktivitete ndërgjegjësuëse dhe edukative për sigurinë;
- bashkëpunimin me strukturat e policimit në komunitet;
- kontribuimin në krijimin e një klime të sigurt dhe mbështetëse në shkollë.

Oficeri i sigurisë zhvillon gjithashtu, praktikën profesionale të dokumentimit përmes raporteve, memove, formularëve të referimit, planeve të masave dhe instrumenteve të tjera të përcaktuara nga kuadri institucional i funksionimit të shërbimit.

Në ushtrimin e funksionit të tij, oficeri i sigurisë kontribuon në evidentimin e hershëm të problematikave dhe në koordinimin institucional për trajtimin e tyre, duke respektuar gjithmonë kufijtë e kompetencave profesionale dhe parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

## Çfarë nuk bën oficeri i sigurisë?

Oficeri i sigurisë nuk ushtron kompetenca policore, disiplinore apo terapeutike në institucionin arsimor. Roli i tij nuk lidhet me ndëshkimin e nxënësve, hetimin e rasteve apo zëvendësimin e funksioneve të strukturave të tjera të shkollës dhe të institucioneve përgjegjëse.

Në ushtrimin e detyrës së tij, oficeri i sigurisë:

- nuk merr masa disiplinore ndaj nxënësve;
- nuk vendos sanksione apo ndëshkime;
- nuk kryen procedura hetimore;
- nuk ushtron kompetenca të Policisë së Shtetit;
- nuk zhvillon kontrolle fizike ndaj nxënësve (përveç rasteve të përcaktuara sipas vendimmarrjes dhe procedurave institucionale);
- nuk realizon kontrolle të mjediseve pa procedurat përkatëse institucionale;
- nuk përdor forcë fizike apo mjete shtrënguese;
- nuk zhvillon terapi psikologjike apo ndërhyrje klinike;
- nuk merr vendime pedagogjike;
- nuk zëvendëson rolin e rojës së shkollës;
- nuk zëvendëson rolin e mësuesit, të psikologut apo të punonjësit social.

“Udhëzuesi për praktikën e punës së oficerëve të sigurisë” përcakton se oficeri i sigurisë nuk ndërmerr masa disiplinore në shkollë dhe nuk zhvillon kontrole fizike apo të mjediseve, përveç rasteve të emergjencës dhe të vendimmarrjes institucionale.

Për shkak të natyrës së funksionit të tij, oficeri i sigurisë duhet të shmangë çdo sjellje autoritare, intimiduese apo ndërhyrje, që mund të krijojë perceptimin e një funksioni ndëshkues apo represiv në shkollë. Qasja e tij duhet të mbështetet në komunikim, bashkëpunim, parandalim dhe ndërhyrje institucionale, në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative.

## **Kufijtë e rolit në raport me drejtorinë e institucionit arsimor**

Drejtuesi i institucionit arsimor është autoriteti përgjegjës për organizimin, administrimin dhe funksionimin e përgjithshëm të shkollës. Oficeri i sigurisë ushtron funksionin e tij në bashkëpunim dhe koordinim me drejtuesin e institucionit arsimor dhe nuk vepron si strukturë e pavarur apo paralele ndaj stafit të shkollës.

Oficeri i sigurisë evidenton, monitoron dhe raporton problematikat që lidhen me sigurinë në shkollë, ndërsa vendimmarrja administrative dhe institucionale mbetet kompetencë e drejtuesit të institucionit arsimor.

Në raport me drejtorinë, oficeri i sigurisë:

- bashkëpunon për evidentimin dhe trajtimin e problematikave;
- raporton situatat që cenojnë sigurinë;
- kontribuon në planifikimin e masave parandaluese;
- mbështet zbatimin e procedurave të sigurisë;
- dokumenton praktikën e punës sipas procedurave institucionale.

Oficeri i sigurisë nuk zëvendëson rolin administrativ apo disiplinor të drejtuesit të institucionit arsimor dhe nuk merr vendime që janë kompetencë e stafit të shkollës.

## **Kufijtë e rolit në raport me psikologun e shkollës**

Psikologu i shkollës është specialisti përgjegjës për vlerësimin, mbështetjen dhe ndërhyrjen psiko-sociale dhe psikologjike në institucionin arsimor. Oficeri i sigurisë nuk ushtron funksione psikologjike dhe nuk zhvillon ndërhyrje terapeutike apo klinike me nxënësit.

Roli i oficerit të sigurisë në raport me psikologun, lidhet me evidentimin dhe referimin e rasteve që paraqesin problematika emocionale, sjellore apo sociale, që mund të ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve.

Në këtë kuadër, oficeri i sigurisë:

- koordinohet me psikologun për evidentimin e rasteve me risk;
- referon situata problematike;
- kontribuon në monitorimin e klimës së shkollës;
- mbështet aktivitetet parandaluese dhe ndërgjegjësuere.

Ai nuk realizon:

- vlerësime psikologjike;
- terapi individuale apo grupi;
- ndërhyrje klinike;
- trajtim emocional apo psikologjik të rasteve.

Kufijtë ndërmjet këtyre dy roleve janë të rëndësishëm për të shmangur mbivendosjen e kompetencave dhe për të garantuar funksionimin korrekt të mekanizmave mbështetës në shkollë.

## Kufijtë e rolit në raport me punonjësin social

Punonjësi social ka rol specifik në trajtimin e problematikave sociale, familjare dhe komunitare, që ndikojnë në zhvillimin dhe mirëqenien e nxënësve. Oficeri i sigurisë nuk zëvendëson funksionet e punës sociale dhe nuk zhvillon menaxhim social të rasteve.

Roli i tij lidhet me evidentimin dhe referimin e rasteve, që paraqesin risk social apo ndikojnë në sigurinë e nxënësve dhe klimën e shkollës.

Në raport me punonjësin social, oficeri i sigurisë:

- evidenton situatat problematike;
- referon rastet sipas procedurave institucionale;
- bashkëpunon për ndjekjen e rasteve me risk;
- kontribuon në aktivitetet parandaluese dhe komunitare.

Ai nuk zhvillon:

- vlerësim social profesional;
- ndërhyrje sociale të specializuara;
- menaxhim të plotë të rastit;
- trajtim social apo familjar të problematikave.

## Kufijtë e rolit në raport me mësuesin

Mësuesi është figura kryesore pedagogjike dhe edukative në institucionin arsimor. Oficeri i sigurisë nuk ushtron funksione pedagogjike dhe nuk zëvendëson rolin edukativ të mësuesit në procesin mësimor.

Në raport me mësuesin, oficeri i sigurisë:

- bashkëpunon për evidentimin e problematikave që lidhen me sigurinë;
- kontribuon në ruajtjen e klimës së sigurt në klasë dhe në shkollë;
- mbështet aktivitetet parandaluese dhe ndërgjegjëse;
- referon dhe dokumenton situatat problematike sipas procedurave institucionale.

Ai nuk:

- zhvillon proces mësimor;
- realizon vlerësim pedagogjik të nxënësve;
- merr vendime pedagogjike;
- zëvendëson autoritetin e mësuesit në klasë.

Roli i oficerit të sigurisë në raport me mësuesin është rol mbështetës dhe bashkëpunues, në funksion të garantimit të një mjedisi të sigurt dhe pozitiv për zhvillimin e procesit edukativ dhe mësimor.

## Kufijtë e rolit në raport me Policinë e Shtetit

Oficeri i sigurisë bashkëpunon me strukturat e Policisë së Shtetit dhe veçanërisht me specialistët e policimit në komunitet, në funksion të garantimit të sigurisë në shkollë dhe përreth saj. Megjithatë, ai nuk është punonjës policie dhe nuk ushtron kompetenca ligjzbatuese apo procedurale.

Roli i oficerit të sigurisë lidhet me:

- evidentimin e situatave problematike;
- monitorimin e sigurisë në shkollë;
- raportimin institucional;
- bashkëpunimin dhe koordinimin me policinë në rastet e nevojshme.

Ai nuk:

- kryen procedura hetimore;
- realizon ndalime;
- ushtron kontroll fizik ndaj nxënësve (përveç rasteve emergjente dhe me miratimin e titullarit të institucionit arsimor);
- përdor forcë fizike;
- kryen sekuestre;
- ushtron kompetenca procedurale penale.

Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit realizohet në funksion të parandalimit dhe të garantimit të sigurisë publike dhe jo në funksion të policimit të mjedisit shkollor.

# PROFILI PROFESIONAL I OFICERIT TË SIGURISË

Profili profesional i oficerit të sigurisë në institucionet arsimore parauniversitare ndërtohet mbi një kombinim vlerash profesionale, aftësish praktike, kompetencash institucionale dhe standardesh etike, që orientojnë mënyrën e ushtrimit të detyrës dhe marrëdhëniet me komunitetin shkollor. Për shkak të natyrës së ndjeshme të funksionit të tij dhe të rolit që luan në garantimin e sigurisë në shkollë, oficeri i sigurisë duhet të karakterizohet nga stabiliteti profesional, integriteti moral, aftësi komunikimi dhe përgjegjshmëria institucionale.

Profili profesional i oficerit të sigurisë nuk lidhet vetëm me praninë fizike apo monitorimin e mjedisit shkollor, por me aftësinë për të ndërtuar marrëdhënie bashkëpunuese, për të evidentuar problematikat në mënyrë profesionale, për të reaguar në mënyrë të kontrolluar në situata problematike dhe për të kontribuar në krijimin e një klime të sigurt dhe mbështetëse në institucionin arsimor.

Në ushtrimin e detyrës së tij, oficeri i sigurisë duhet të jetë në gjendje të ndërthurë:

- respektimin e kuadrit ligjor;
- komunikimin profesional;
- aftësitë parandaluese;
- monitorimin dhe dokumentimin;
- bashkëpunimin institucional;
- menaxhimin e situatave problematike dhe emergjente.

Ky profil profesional duhet të reflektojë qartë natyrën parandaluese dhe bashkëpunuese të funksionit të oficerit të sigurisë në shkollë dhe të shmangë perceptimin e tij si figurë ndëshkuese apo policore brenda institucionit arsimor.

## Vlerat profesionale

### Integriteti

Integriteti përbën një nga vlerat themelore të profilit profesional të oficerit të sigurisë dhe lidhet me ndershmërinë, korrektësinë dhe përgjegjshmërinë në ushtrimin e detyrës.

Për shkak të rolit që ka në komunitetin shkollor dhe të nivelit të besimit që kërkohet për ushtrimin e këtij funksioni, oficeri i sigurisë duhet të tregojë standarde të larta integriteti moral dhe profesional në çdo veprim dhe marrëdhënie institucionale.

Integriteti reflektohet në mënyrën se si oficeri i sigurisë:

- zbaton detyrat funksionale;
- respekton kuadrin ligjor;
- komunikon me nxënësit dhe stafin;
- menaxhon informacionin institucional;
- trajton situatat problematike;
- shmang konfliktin e interesit dhe sjelljet e papërshtatshme profesionale.

Oficeri i sigurisë duhet të ushtrojë funksionin e tij me ndershmëri, paanshmëri dhe korrektësi, duke ruajtur besueshmërinë profesionale dhe figurën institucionale në raport me komunitetin shkollor.

### **Vetëkontrolli**

Për shkak të ndërveprimit të vazhdueshëm me situata problematike, konflikte apo episode tensioni në mjedisin shkollor, oficeri i sigurisë duhet të karakterizohet nga nivel i lartë vetëkontrolli dhe stabilitet emocional.

Vetëkontrolli lidhet me aftësinë për të menaxhuar emocionet, reagimet dhe sjelljen profesionale edhe në situata të vështira apo provokuese. Në ushtrimin e detyrës së tij, oficeri i sigurisë duhet të ruajë qetësinë, objektivitetin dhe kontrollin profesional, duke shmangur reagimet impulsive, gjuhën agresive apo sjelljet që mund të përshkallëzojnë konfliktin.

Vetëkontrolli është element thelbësor për:

- menaxhimin korrekt të situatave konfliktuale;
- ndërmjetësimin profesional;
- komunikimin efektiv me nxënësit;
- ruajtjen e autoritetit profesional;
- garantimin e një klime të sigurt dhe jo tensionuese në shkollë.

### **Diskrecioni**

Diskrecioni lidhet me aftësinë e oficerit të sigurisë për të trajtuar informacionin profesional me kujdes, maturi dhe konfidencialitet.

Në ushtrimin e detyrës së tij, oficeri i sigurisë mund të ketë akses në informacione sensitive, që lidhen me nxënësit, familjet e tyre, situata konfliktuale apo problematika të ndryshme, që cenojnë sigurinë dhe mirëqenien e komunitetit shkollor.

Për këtë arsye, ai duhet të tregojë maturi profesionale në mënyrën se si administron, komunikon dhe dokumenton informacionin institucional. Diskrecioni kërkon që oficeri i sigurisë:

- të ruajë konfidencialitetin;
- të shmangë shpërndarjen e informacionit të persona të paautorizuar;
- të mos ekspozojë nxënësit apo problematikat sensitive;
- të përdorë informacionin vetëm në funksion të garantimit të sigurisë dhe të mbrojtjes së nxënësve.

Ruajtja e diskrecionit profesional është thelbësore për ndërtimin e besimit të komunitetit shkollor ndaj figurës së oficerit të sigurisë.

## **Paanësia**

Oficeri i sigurisë duhet të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të paanshme dhe objektive, pa u ndikuar nga preferenca personale, paragjykime, interesa individuale apo marrëdhënie personale me nxënësit, stafin apo komunitetin.

Paanësia lidhet me trajtimin e drejtë dhe të barabartë të çdo situatë dhe të çdo nxënësi, duke respektuar dinjitetin dhe të drejtat e secilit individ. Në trajtimin e problematikave apo të incidenteve, oficeri i sigurisë duhet të mbështetet në faktet e evidentuara, procedurat institucionale dhe standardet profesionale, duke shmangur subjektivizmin apo favorizimin.

Paanësia është element i rëndësishëm për:

- ruajtjen e besueshmërisë profesionale;
- garantimin e drejtësisë në trajtimin e situatave;
- krijimin e një klime besimi në komunitetin shkollor;
- shmangien e konflikteve dhe të perceptimeve negative ndaj rolit të oficerit të sigurisë.

## **Shembulli pozitiv**

Oficeri i sigurisë përfaqëson një figurë të dukshme institucionale në shkollë dhe, për këtë arsye, sjellja e tij profesionale dhe personale ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si perceptohet siguria dhe autoriteti institucional në komunitetin shkollor.

Ai duhet të shërbejë si model pozitiv në:

- komunikim;
- sjellje;
- etikë profesionale;
- respektim të rregullave;
- menaxhim të situatave problematike;
- bashkëpunim me të tjerët.

Sjellja e oficerit të sigurisë duhet të reflektojë korrektësi, maturi, respekt dhe përgjegjshmëri institucionale, duke kontribuar në krijimin e një kulture pozitive sigurie dhe bashkëjetese në shkollë.

## Kompetencat profesionale

Kompetencat profesionale të oficerit të sigurisë përfshijnë tërësinë e integruar të njohurive teorike, të aftësive praktike, të vlerave dhe të qëndrimeve të nevojshme për të ushtruar detyrën në mënyrë efektive, ligjore dhe etike në institucionet arsimore parauniversitare. Ky profil profesional nuk është thjesht një listë detyrash administrative, por një kornizë komplekse operacionale e cila bazohet në parimin e sigurisë parandaluese dhe komunitare.

Për t'iu përgjigjur natyrës ndërdisiplinore të sigurisë në shkolla, kompetenca e oficerit të sigurisë strukturohet sipas tri dimensioneve ndërlidhëse:

- **Dimensioni kognitiv (Njohuritë):**

Oficeri i sigurisë zotëron njohuri të thelluara mbi kuadrin ligjor arsimor, të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, rreziqet bashkëkohore (përfshirë ato në mjedisin digjital), si dhe protokollet institucionale të menaxhimit të krizave dhe të emergjencave.

- **Dimensioni Praktik (Aftësitë):**

Oficeri i sigurisë demonstroi aftësi operative për të monitoruar mjedisin, për të zbatuar teknikat e de-eskalimit verbal, për të ndërmjetësuar konfliktet në faza të hershme, për të bashkëpunuar me rrjetet multidisiplinare (ShPS, NjMF, Policia e Shtetit) dhe për të dokumentuar zyrtarisht çdo veprimtari.

- **Dimensioni afektiv (Qëndrimet dhe vlerat):**

Oficeri i sigurisë udhëhiqet nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, duke dëshmuar integritet, vetëkontroll emocional në situata tensioni, paanshmëri absolute, diskrecion, respekt për privatësinë dhe një qasje gjithëpërfshirëse e jodiskriminuese.

### Kompetenca ligjore

Oficeri i sigurisë duhet të zotërojë njohuri të qarta mbi kuadrin ligjor dhe institucional që rregullon funksionimin e tij, organizimin e institucioneve arsimore dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Kompetenca ligjore lidhet me njohjen dhe zbatimin korrekt të:

- legjislacionit për arsimin parauniversitar;
- legjislacionit për mbrojtjen e fëmijës;
- akteve nënligjore për funksionimin e oficerit të sigurisë;
- procedurave të referimit dhe të raportimit;
- rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale;
- kufijve të kompetencave profesionale.

Kjo kompetencë është thelbësore për garantimin e ligjshmërisë dhe të korrektësisë në ushtrimin e funksionit të oficerit të sigurisë.

### **Kompetenca operacionale**

Kompetenca operacionale lidhet me aftësinë për të organizuar, për të monitoruar dhe për të realizuar praktikën e përditshme të punës, në funksion të garantimit të sigurisë në institucionin arsimor.

Kjo kompetencë përfshin:

- monitorimin e mjediseve shkollore;
- evidentimin e situatave me risk;
- reagimin ndaj incidenteve;
- zbatimin e procedurave të sigurisë;
- organizimin e masave parandaluese;
- administrimin e dokumentacionit profesional.

Kompetenca operacionale ndihmon oficerin e sigurisë të zhvillojë një praktikë të strukturuar, funksionale dhe efektive në institucionin arsimor.

### **Kompetenca komunikuese**

Për shkak të ndërveprimit të vazhdueshëm me nxënësit, stafin pedagogjik, prindërit dhe institucionet e tjera, oficeri i sigurisë duhet të zotërojë aftësi të mira komunikimi profesional.

Kompetenca komunikuese lidhet me:

- komunikimin verbal dhe joverbal;
- dëgjimin aktiv;
- menaxhimin e konflikteve;
- ndërmjetësimin;
- komunikimin në situata tensioni;
- ndërtimin e marrëdhënieve të besimit me komunitetin shkollor.

Komunikimi profesional është element kyç, për parandalimin e konflikteve dhe krijimin e një klime të sigurt dhe bashkëpunuese në shkollë.

### **Kompetenca parandaluese**

Kompetenca parandaluese lidhet me aftësinë për të evidentuar faktorët e riskut dhe për të ndërmarrë veprime që kontribuojnë në shmangien e situatave problematike në shkollë.

Kjo kompetencë përfshin:

- identifikimin e hershëm të problematikave;
- evidentimin e sjelljeve me risk;
- monitorimin e klimës së shkollës;
- bashkëpunimin për ndërhyrje parandaluese;
- mbështetjen e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukative.

Kompetenca parandaluese është element thelbësor i profilit profesional të oficerit të sigurisë dhe përfaqëson bazën e rolit të tij në institucionin arsimor.

### **Kompetenca dokumentuese**

Oficeri i sigurisë duhet të jetë i aftë të dokumentojë në mënyrë korrekte, të strukturuar dhe profesionale praktikën e punës dhe situatat e evidentuara në institucionin arsimor.

Kjo kompetencë lidhet me:

- hartimin e raporteve;
- plotësimin e formularëve;
- evidentimin e incidenteve;
- mbajtjen e dokumentacionit profesional;
- administrimin e informacionit institucional;
- raportimin sipas procedurave të përcaktuara.

Dokumentimi korrekt garanton gjurmueshmëri, llogaridhënie dhe monitorim të praktikës së punës së oficerit të sigurisë.

### **Kompetenca bashkëpunuese**

Kompetenca bashkëpunuese lidhet me aftësinë për të ndërtuar dhe për të ruajtur marrëdhënie profesionale me strukturat e shkollës dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

Kjo kompetencë përfshin:

- bashkëpunimin me drejtuesin e shkollës;
- bashkëpunimin me stafin pedagogjik;
- koordinimin me shërbimin psiko-social;
- bashkëpunimin me strukturat e policimit në komunitet;
- komunikimin me prindërit dhe institucionet mbështetëse.

Bashkëpunimi institucional është element thelbësor për garantimin e sigurisë dhe trajtimin efektiv të problematikave në shkollë.

### **Kompetenca digjitale**

Në kushtet e zhvillimit të teknologjisë dhe të rritjes së përdorimit të mjeteve digjitale në mjedisin shkollor, oficeri i sigurisë duhet të zotërojë kompetenca bazë digjitale, për administrimin e informacionit dhe evidentimin e problematikave që lidhen me sigurinë online.

Kjo kompetencë përfshin:

- përdorimin e mjeteve digjitale të raportimit;
- administrimin elektronik të dokumentacionit;
- njohjen e risqeve që lidhen me cyberbullizmin;
- evidentimin e problematikave që lidhen me sigurinë online;
- përdorimin korrekt të informacionit dhe të të dhënave elektronike.

### **Kompetenca për menaxhimin e krizave**

Oficeri i sigurisë duhet të jetë i aftë të reagojë në mënyrë të organizuar, të kontrolluar dhe profesionale në situata emergjente apo krizash në institucionin arsimor.

Kjo kompetencë lidhet me:

- menaxhimin e situatave konfliktuale;
- reagimin në incidente;
- koordinimin institucional në emergjencë;
- menaxhimin e panikut;
- ndërhyrjen fillestare në situata risku;
- bashkëpunimin me strukturat përgjegjëse për emergjencat.

Kompetenca për menaxhimin e krizave është e rëndësishme për garantimin e sigurisë së komunitetit shkollor dhe minimizimin e pasojave në situata emergjente apo incidente të rënda.

# STANDARDET PROFESIONALE TË OFICERËVE TË SIGURISË NË SHKOLLA

## Struktura dhe ndërtimi i standardeve profesionale të oficerit të sigurisë

Standardet profesionale për oficerin e sigurisë në institucionet arsimore, janë ndërtuar mbi bazën e funksioneve, të përgjegjësi dhe të kompetencave që lidhen me garantimin e sigurisë, të mbrojtjes dhe të mirëqenies së komunitetit shkollor. Ato synojnë të krijojnë një kuadër të unifikuar profesional për ushtrimin e rolit të oficerit të sigurisë, duke përcaktuar qartë pritshmëritë profesionale, sjelljet funksionale dhe treguesit e performancës që duhet të demonstrohen në praktikën e përditshme të punës.

Ndërtimi i standardeve është mbështetur në legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi për arsimin parauniversitar, mbrojtjen e fëmijëve, sigurinë në institucionet arsimore, të drejtat e njeriut, mbrojtjen e të dhënave personale dhe bashkëpunimin ndër-institucional. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë praktikat institucionale, nevojat reale të institucioneve arsimore dhe kërkesat bashkëkohore për menaxhimin e sigurisë dhe parandalimin e riskut në mjediset shkollore.

Struktura e standardeve është konceptuar në mënyrë funksionale dhe kompetencash. Çdo standard përfaqëson një fushë kryesore të ushtrimit të detyrës së oficerit të sigurisë dhe përfshin elementet kryesore të mëposhtme:

- titullin e standardit, i cili përcakton fushën profesionale që mbulon standardi;
- përkufizimin e standardit, që shpjegon në mënyrë të përmblëdhur qëllimin dhe fokusin e tij;
- përshkrimin e standardit, ku paraqitet rëndësia e kompetencës dhe roli i saj në funksionimin e sigurt të institucionit arsimor;
- treguesit e performancës, të cilët përshkruajnë veprimet konkrete, sjelljet profesionale dhe rezultatet e pritshme që oficeri i sigurisë duhet të demonstrojë në praktikë;
- elementet e dokumentimit dhe të evidencës, të integruara brenda treguesve të performancës, për të verifikuar, për të gjurmuar dhe për të monitoruar realizimin e standardit.

Standardet janë ndërtuar sipas një qasjeje parandaluese, mbrojtëse dhe bashkëpunuese, duke e konsideruar oficerin e sigurisë jo vetëm si strukturë monitoruese dhe reaguese, por edhe si aktor edukues, koordinues dhe mbështetës në komunitetin shkollor. Në këtë kuadër, standardet adresojnë jo vetëm aspektet e sigurisë fizike dhe të reagimit ndaj incidenteve, por edhe komunikimin me nxënësit, parandalimin e dhunës, menaxhimin e rasteve, edukimin për sigurinë, etikën profesionale, bashkëpunimin ndërinstitutional dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm.

Treguesit e performancës janë formuluar në mënyrë të matshme, të vëzhgueshme dhe të dokumentueshme, në mënyrë që standardet të shërbejnë si instrument orientues për:

- ushtrimin e funksionit të oficerit të sigurisë;
- vlerësimin e performancës profesionale;
- identifikimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional;
- monitorimin institucional të cilësisë së shërbimit;
- hartimin e planeve të punës dhe të procedurave operative në institucionet arsimore.

Në tërësi, këto standarde synojnë të kontribuojnë në forcimin e kulturës së sigurisë në shkollë, rritjen e profesionalizmit të oficerëve të sigurisë dhe garantimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbrojtës për çdo nxënës dhe anëtar të komunitetit arsimor.

# Standardi 1: Planifikimi, organizimi i punës, dokumentimi dhe raportimi profesional

## Përkufizimi i standardit

Oficeri i sigurisë planifikon, organizon dhe menaxhon në mënyrë profesionale aktivitetin e tij, duke hartuar plane pune dhe masa konkrete për garantimin e sigurisë në institucionin arsimor, si dhe duke administruar në mënyrë efektive kohën, prioritetet dhe detyrat funksionale. Oficeri i sigurisë dokumenton, administron dhe raporton në mënyrë të saktë, profesionale dhe konfidenciale çdo informacion, incident, aktivitet dhe ndërhyrje, që lidhet me sigurinë në institucionin arsimor, duke garantuar gjurmueshmërinë, transparencën dhe respektimin e procedurave institucionale dhe ligjore.

## Përshkrimi i standardit

Ky standard lidhet me aftësinë e oficerit të sigurisë për të organizuar punën në mënyrë të strukturuar, të koordinuar dhe të orientuar, drejt parandalimit dhe menaxhimit të problematikave të sigurisë. Planifikimi profesional mundëson identifikimin e nevojave prioritare, koordinimin me strukturat e shkollës dhe realizimin e detyrave në përputhje me objektivat institucionale dhe procedurat ligjore. Oficeri i sigurisë duhet të përdorë instrumente planifikimi, monitorimi dhe vlerësimi për të garantuar efikasitetin e veprimtarisë së tij.

Ky standard lidhet me aftësinë e oficerit të sigurisë për të mbajtur dokumentacion të plotë, të strukturuar dhe të verifikueshëm mbi aktivitetin profesional. Dokumentimi dhe raportimi i saktë mundësojnë monitorimin e situatave të sigurisë, analizimin e problematikave, ndjekjen e rasteve dhe marrjen e vendimeve të bazuara në evidenca. Oficeri i sigurisë duhet të ruajë konfidencialitetin, të sigurojë gjurmueshmërinë e informacionit dhe të përdorë formatet institucionale të miratuara për raportim dhe evidencë.

## *Oficeri i sigurisë:*

- Strukturon detyrat ditore dhe periodike sipas prioriteteve të institucionit.
- Koordinon aktivitetet me drejtuesit, stafin pedagogjik dhe strukturat mbështetëse.
- Siguron realizimin në kohë të detyrave dhe të përgjegjësiave funksionale.
- Menaxhon komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit të nevojshëm për realizimin e detyrave.
- Ndjek realizimin e aktiviteteve dhe evidenton problematikat gjatë procesit të punës.
- Përshtat organizimin e punës sipas situatave emergjente ose nevojave institucionale.
- Identifikon problematikat që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme ose prioritare.

- Vlerëson nivelin e riskut dhe ndikimin e situatave në sigurinë e institucionit.
- Përcakton rendin e ndërhyrjeve bazuar në urgjencën dhe rëndësinë e rasteve.
- Ndjek dhe monitoron rastet deri në përfundimin ose stabilizimin e situatës.
- Evidenton procesin e vlerësimit dhe të ndërhyrjes sipas procedurave institucionale.
- Planifikon kohën e punës në funksion të realizimit të objektivave dhe të detyrave prioritare.
- Organizon aktivitetet duke respektuar afatet dhe kërkesat institucionale.
- Menaxhon ngarkesën e punës dhe shpërndarjen e aktiviteteve sipas nevojave.
- Përdor mjete organizative dhe administrative për monitorimin e detyrave dhe të aktiviteteve.
- Reagon në mënyrë fleksibël ndaj situatave të paplanifikuara ose emergjente.
- Vlerëson efektivitetin e organizimit të punës dhe ndërmerr masa për përmirësim.
- Harton planin vjetor të veprimtarive, në përputhje me nevojat dhe prioritetet e institucionit arsimor.
- Harton planin e sigurisë së shkollës, duke evidentuar risqet e mundshme, daljet emergjente dhe masat për minimizimin e burimeve të aksidenteve dhe të situatave me risk.
- Harton memo dhe komunikime zyrtare për informimin e drejtuesve dhe të strukturave përgjegjëse mbi problematikat që cenojnë sigurinë në institucionin arsimor.
- Përgatit raporte periodike mbi situatën e sigurisë, problematikat e evidentuara dhe ndërhyrjet e realizuara në institucionin arsimor.
- Harton raportin vjetor të veprimtarisë, duke përmbledhur realizimin e planit vjetor, aktivitetet e zhvilluara, problematikat e evidentuara dhe rezultatet e punës së realizuar gjatë vitit shkollor.
- Mban procesverbale për mbledhjet, analizat e rasteve, takimet ndërinstitucionale dhe aktivitetet parandaluese të zhvilluara në shkollë.
- Dokumenton takimet dhe komunikimet me drejtuesit, stafin pedagogjik, ShPS-në, Policinë e Shtetit, NjMF-në, prindërit dhe institucionet e tjera bashkëpunuese.
- Përdor gjuhë profesionale, objektive dhe të verifikueshme në hartimin e dokumentacionit dhe të raportimit institucional.
- Arkivon dhe administron dokumentacionin sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara nga institucioni dhe legjislacioni në fuqi.
- Sinjalizon në mënyrë parandaluese problematikat dhe situatat me risk, përmes vlerësimit të hershëm të rrezikut dhe përdorimit të formatit të shkresës “Memo”.
- Përgatit raporte incidenti, duke përshkruar në mënyrë objektive ngjarjen, personat e përfshirë, masat e marra dhe strukturat e njoftuara sipas procedurave institucionale.
- Dokumenton situatat problematike, rastet e dhunës, të bullizmit, të konflikteve dhe të sjelljeve me risk të evidentuara në shkollë.
- Evidenton problematikat dhe vështirësitë e hasura gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe masat ose zgjidhjet e ofruara për trajtimin e tyre.

- Dokumenton ndërhyrjet parandaluese, aktivitetet ndërgjegjësuese dhe takimet informuese të organizuara me nxënësit dhe prindërit.
- Dokumenton ndërhyrjet në situata emergjente dhe masat e marra për menaxhimin e incidenteve ose të krizave në shkollë.
- Dokumenton ndërhyrjet përmes kontrollit fizik në situata emergjente, duke evidentuar arsyet e ndërhyrjes, personat e përfshirë, masat e marra dhe procedurat e ndjekura sipas rregullave institucionale.
- Plotëson formularët e referimit dhe administron dokumentacionin e rasteve të referuara pranë strukturave përgjegjëse.
- Administron evidencat e monitorimit të mjediseve të brendshme dhe të jashtme të institucionit arsimor.
- Administron dokumentacionin profesional në mënyrë të strukturuar, të verifikueshme dhe të aksesueshme sipas procedurave institucionale.
- Ruan dokumentacionin fizik dhe digjital, duke respektuar rregullat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.
- Kufizon aksesin në informacion dhe dokumentacion vetëm për personat dhe strukturat e autorizuara.
- Siguron gjurmueshmërinë e informacionit dhe të ndërhyrjeve përmes administrimit korrekt të evidencave dhe të dokumentacionit institucional.

## Standardi 2: Siguria fizike dhe monitorimi i mjedisit shkollor

### Përkufizimi i standardit

Oficeri i sigurisë monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme mjedisin fizik të institucionit arsimor, duke identifikuar risqet, duke kontrolluar perimetrin dhe sistemet e sigurisë, si dhe duke garantuar hyrje-dalje të kontrolluara dhe kushte të sigurt për komunitetin shkollor.

### Përshkrimi i standardit

Ky standard lidhet me aftësinë e oficerit të sigurisë për të garantuar sigurinë fizike në institucionin arsimor, përmes monitorimit sistematik të mjediseve, kontrollit të aksesit dhe evidentimit të problematikave që mund të cenojnë sigurinë e nxënësve dhe të stafit. Oficeri i sigurisë duhet të identifikojë risqet infrastrukturore dhe operative, duhet të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse për adresimin e tyre dhe duhet të sigurojë funksionimin efektiv të masave dhe të sistemeve të sigurisë në shkollë.

#### *Oficeri i sigurisë:*

- Kryen monitorim periodik të mjediseve të brendshme dhe të jashtme të institucionit arsimor.
- Vëzhgon situatat dhe sjelljet që mund të përbëjnë rrezik për sigurinë e komunitetit shkollor.
- Evidenton problematikat që lidhen me rendin, sigurinë dhe mirëmbajtjen e mjediseve.
- Reagon dhe informon strukturat përgjegjëse për çdo situatë të evidentuar.
- Mbështet drejtuesit dhe stafin pedagogjik për ruajtjen e sigurisë në mjediset shkollore.
- Monitorin lëvizjet në perimetrin dhe brenda hapësirës së perimterit të sigurisë së institucionit arsimor.
- Evidenton persona të paautorizuar ose situata që cenojnë sigurinë e institucionit.
- Merr masa të menjëhershme për njoftimin e Policisë së Shtetit në rastet e cenimit të sigurisë së perimetrit.
- Identifikon situata, objekte ose kushte që mund të përbëjnë risk për sigurinë fizike.
- Identifikon risqet dhe ndikimin e mundshëm në komunitetin shkollor.
- Evidenton problematikat që lidhen me sigurinë infrastrukturore.
- Informon drejtuesit dhe strukturat përgjegjëse për risqet e evidentuara.
- Propozon masa parandaluese ose korrigjuese për minimizimin e risqeve.
- Monitoron ndjekjen dhe adresimin e problematikave të raportuara.
- Monitoron hyrje-daljet gjatë orareve të fillimit të procesit mësimor dhe të përfundimit të tij.

- Monitoron lëvizjet e nxënësve dhe të vizitorëve gjatë orarit shkollor.
- Evidenton dhe raporton largimet e paautorizuara ose hyrjet e paidentifikuara në institucion.
- Ndërvepron me stafin dhe drejtuesit për garantimin e sigurisë gjatë fluksit të hyrje-daljeve.
- Merr masa për shmangien e situatave që rrezikojnë rendin dhe sigurinë në hyrje-dalje.
- Identifikon dëmtime ose problematika infrastrukturore që cenojnë sigurinë fizike.
- Evidenton problematika që lidhen me ndriçimin, daljet emergjente, gardhet, dyert, dritaret ose mjediset e përbashkëta.
- Raporton nevojat për ndërhyrje ose mirëmbajtje te drejtuesit dhe strukturat përgjegjëse.
- Monitoron ndjekjen e masave për eliminimin e problematikave infrastrukturore.
- Informon komunitetin shkollor për masat e sigurisë në rastet e problematikave infrastrukturore.

## Standardi 3: Përdorimi i teknologjisë dhe siguria e informacionit

### Përkufizimi i standardit

Oficeri i sigurisë përdor teknologjinë dhe administron informacionin në mënyrë të sigurt, profesionale dhe etike, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave, privatësinë dhe përdorimin e kontrolluar të sistemeve dhe të pajisjeve të sigurisë në institucionin arsimor.

### Përshkrimi i standardit

Ky standard lidhet me aftësinë e oficerit të sigurisë për të përdorur pajisjet dhe sistemet teknologjike që mbështesin sigurinë në shkollë, si dhe për të administruar informacionin sipas standardeve të konfidencialitetit, të etikës profesionale dhe të mbrojtjes së të dhënave personale. Oficeri i sigurisë duhet të njohë procedurat për përdorimin e sistemeve të monitorimit, ruajtjen e evidencave dhe menaxhimin e informacionit sensitiv, duke respektuar legjislacionin dhe rregullat institucionale për privatësinë dhe sigurinë digjitale.

### Oficeri i sigurisë:

- Përdor sistemet CCTV dhe pajisjet e monitorimit vizual, në përputhje me procedurat institucionale dhe legjislacionin në fuqi, duke respektuar rreptësisht kufijtë ligjorë dhe etikë.
- Kufizon aksesin në pamjet dhe të dhënat e monitorimit vetëm për personat e autorizuar.
- Kontrollon periodikisht pajisjet emergjente, mjetet e mbrojtjes dhe sistemet teknologjike të sigurisë për përdorimin e tyre korrekt dhe të kontrolluar.
- Evidenton defektet ose mosfunksionimet e pajisjeve dhe informon menjëherë strukturat përgjegjëse për nevojat e mirëmbajtjes apo të riparimit.
- Administron dhe ruan dokumentacionin profesional, fizik dhe digjital, në mënyrë të strukturuar dhe sipas procedurave të sigurisë së informacionit.
- Garanton krijimin e kopjeve rezervë (backup) dhe ruajtjen e kontrolluar të të dhënave me rëndësi për sigurinë e institucionit arsimor.
- Zbaton afatet dhe procedurat zyrtare për arkivimin, konfidencialitetin dhe asgjësimin e dokumentacionit institucional.
- Evidenton dhe raporton menjëherë çdo rast të humbjes, të dëmtimit ose të aksesit të paautorizuar në të dhënat e institucionit.
- Zbaton mjete dhe praktika standarde për mbrojtjen e informacionit digjital, duke përfshirë përdorimin e fjalëkalimeve të sigurta dhe rregullat e aksesit në sisteme.
- Përdor emailin institucional, pajisjet dhe sistemet elektronike vetëm për qëllime profesionale dhe zyrtare.

- Identifikon dhe sinjalizon rreziqet që lidhen me sigurinë kibernetike apo keqpërdorimin e pajisjeve digjitale brenda institucionit.
- Vepron në përputhje të plotë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar privatësinë e nxënësve, të stafit dhe të familjeve nga çdo përdorim i paautorizuar.
- Ruan konfidencialitetin dhe etikën profesionale, duke shmangur kategorikisht përdorimin e informacionit zyrtar për qëllime personale apo jashtë kompetencave funksionale.
- Kufizon shpërndarjen e informacionit sensitiv vetëm mbi bazën e nevojës institucionale dhe vetëm te strukturat apo personat kompetentë, duke ndaluar ekspozimin apo publikimin e tij në platforma apo kanale të pasigurta.

## Standardi 4: Menaxhimi i situatave problematike dhe emergjente

### Përkufizimi i standardit

Oficeri i sigurisë reagon në mënyrë të shpejtë, të koordinuar dhe profesionale në situata problematike, incidente dhe emergjenca, duke zbatuar procedurat institucionale të sigurisë, të mbrojtjes dhe të evakuimit, për garantimin e sigurisë së komunitetit shkollor.

### Përshkrimi i standardit

Ky standard lidhet me aftësinë e oficerit të sigurisë për të menaxhuar situata emergjente dhe problematika, që cenojnë sigurinë fizike dhe psikologjike në institucionin arsimor. Oficeri i sigurisë duhet të identifikojë dhe duhet vlerësojë situatat e riskut, të ndërhyjë në kohë, të koordinojë reagimin institucional dhe të bashkëpunojë me strukturat e emergjencës dhe aktorët përgjegjës. Ai duhet të njohë procedurat e evakuimit, të menaxhimit të panikut dhe të ndihmës së parë bazë, duke kontribuar në minimizimin e pasojave dhe ruajtjen e rendit e të sigurisë.

### *Oficeri i sigurisë:*

- Ndërhyn përmes kontrollit fizik vetëm në situata emergjente, kur ekziston rrezik i menjëhershëm për sigurinë e nxënësit, të personave të tjerë ose të mjedisit shkollor.
- Realizon kontrollin fizik vetëm si masë e fundit, pasi janë ezauruar format verbale të komunikimit dhe të de-eskalimit të situatës.
- Përdor forma proporcionale, të kontrolluara dhe jo dëmtuese të ndërhyrjes fizike, në përputhje me procedurat institucionale dhe parimin e mbrojtjes së fëmijës.
- Respekton dinjitetin, integritetin fizik dhe të drejtat e nxënësit gjatë çdo ndërhyrjeje fizike.
- Dokumenton në mënyrë të detajuar rrethanat, arsyet, mënyrën e ndërhyrjes dhe personat e përfshirë në kontrollin fizik të realizuar.
- Identifikon dhe vlerëson situatat që cenojnë sigurinë dhe rendin në institucion.
- Reagon në kohë dhe sipas procedurave institucionale ndaj incidenteve të evidentuara.
- Ruan qetësinë dhe kontrollin profesional gjatë ndërhyrjes në incidente.
- Merr masa të menjëhershme për garantimin e sigurisë së nxënësve dhe të stafit.
- Informon drejtuesit dhe strukturat përgjegjëse për incidentet e ndodhura.
- Kufizon përshkallëzimin e situatave përmes ndërhyrjes profesionale dhe komunikimit të kontrolluar.
- Identifikon situata krizash që kërkojnë ndërhyrje të koordinuar institucionale.
- Zbaton procedurat dhe planet e reagimit në raste krizash ose emergjencash.

- Mbështet drejtuesit dhe strukturat përgjegjëse për koordinimin e reagimit institucional.
- Merr masa për mbrojtjen dhe orientimin e komunitetit shkollor gjatë krizave.
- Menaxhon komunikimin institucional në mënyrë të kontrolluar dhe profesional.
- Monitoron zhvillimin e situatës dhe përshtat ndërhyrjen sipas nivelit të riskut.
- Dokumenton menaxhimin e krizës përmes raporteve operative, planeve të masave dhe evidencave të ndërhyrjes.
- Njeh dhe zbaton procedurat e evakuimit të institucionit arsimor.
- Orienton nxënësit dhe stafin gjatë situatave që kërkojnë evakuim emergjent.
- Kontrollon respektimin e rrugëve dhe të pikave të evakuimit.
- Bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për organizimin e simulimeve dhe të ushtrimeve emergjente.
- Evidenton problematikat që lidhen me procedurat ose infrastrukturën e evakuimit.
- Ndhmon në garantimin e rendit dhe shmangien e kaosit gjatë evakuimit.
- Ruan komunikim të qartë dhe të qetë gjatë situatave të panikut.
- Ndhmon nxënësit dhe stafin për të ndjekur udhëzimet e sigurisë në mënyrë të kontrolluar.
- Përdor teknika bazë të menaxhimit të situatave emocionale dhe të tensionit.
- Shmang sjelljet ose komunikimet që mund të rrisin panikun ose konfuzionin.
- Koordinohet me ShPS-në për menaxhimin emocional të situatave.
- Identifikon persona që kanë nevojë për mbështetje të menjëhershme gjatë emergjencës.
- Informon dhe koordinon veprimet me Policinë e Shtetit, zjarrfikësen, urgjencën mjekësore dhe strukturat e tjera.
- Lehtëson aksesin dhe ndërhyrjen e strukturave të emergjencës në institucion.
- Respekton procedurat institucionale dhe hierarkinë gjatë bashkëpunimit me emergjencat.
- Shkëmben informacionin e nevojshëm në mënyrë profesionale dhe konfidenciale.
- Merr pjesë në aktivitete trajnuese dhe simulime të organizuara nga strukturat e emergjencës.
- Bashkëpunon në analizimin dhe vlerësimin e situatave pas emergjencës.
- Jep ndihmën e parë bazë në rastet emergjente, deri në mbërritjen e shërbimeve specializuese.
- Njeh procedurat bazë të reagimit në raste dëmtimesh, humbjeje ndjenje ose gjendjesh emergjente.
- Përdor pajisjet bazë të ndihmës së parë, sipas procedurave dhe kompetencave funksionale.
- Mundëson mbrojtjen dhe sigurinë e personit të dëmtuar dhe të mjedisit përreth.
- Informon menjëherë strukturat përgjegjëse dhe shërbimet emergjente për rastet e evidentuara.
- Respekton kufijtë profesionalë dhe shmang ndërhyrje që tejkalojnë kompetencat e tij.

## Standardi 5: Parandalimi i dhunës dhe i dukurive negative

### Përkufizimi i standardit

Oficeri i sigurisë identifikon, parandalon dhe adreson në mënyrë të hershme sjelljet dhe situatat, që cenojnë sigurinë dhe mirëqenien në institucionin arsimor, duke ndërmarrë masa parandaluese dhe duke bashkëpunuar me strukturat përkatëse për minimizimin e dhunës dhe të dukurive negative.

### Përshkrimi i standardit

Ky standard lidhet me rolin parandalues të oficerit të sigurisë, në krijimin e një klime të sigurt dhe mbrojtëse në shkollë. Oficeri i sigurisë monitoron situatat dhe sjelljet, që mund të çojnë në dhunë, konflikte, përdorim të substancave ose forma të tjera të sjelljeve me risk, duke ndërhyrë në kohë dhe duke bashkëpunuar me drejtuesit, mësuesit, prindërit dhe institucionet mbështetëse. Qasja parandaluese synon identifikimin e hershëm të problematikave dhe minimizimin e faktorëve, që cenojnë sigurinë dhe bashkëjetesën në komunitetin shkollor.

### *Oficeri i sigurisë:*

- Identifikon situata dhe sjellje që lidhen me bullizmin, cyberbullizmin ose forma të tjera të dhunës.
- Ndërhyn në mënyrë parandaluese për shmangien e përshkallëzimit të konflikteve dhe të dhunës.
- Promovon respektin, tolerancën dhe komunikimin pozitiv ndërmjet nxënësve.
- Informon strukturat përgjegjëse për rastet që kërkojnë ndërhyrje institucionale.
- Identifikon situata tensioni ose konflikti ndërmjet nxënësve ose grupeve.
- Monitoron faktorët që mund të ndikojnë në krijimin e konflikteve në mjedisin shkollor.
- Përdor komunikim profesional dhe ndërhyrje parandaluese për uljen e tensioneve.
- Bashkëpunon me stafin pedagogjik dhe strukturat mbështetëse për menaxhimin e konflikteve.
- Ndhmon në promovimin e dialogut dhe të zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve.
- Evidenton situatat problematike dhe ndjek rastet sipas procedurave institucionale.
- Evidenton sjellje ose situata që mund të lidhen me përdorimin ose shpërndarjen e substancave.
- Informon dhe sensibilizon nxënësit mbi rreziqet e përdorimit të substancave të dëmshme.
- Ushtron kompetenca në përputhje me legjislacionin dhe procedurat institucionale në fuqi, për referimin dhe trajtimin e rasteve.

- Monitoron mjediset dhe situatat që mund të favorizojnë sjellje me risk.
- Raporton te strukturat përgjegjëse çdo rast ose dyshim, që cenon sigurinë e institucionit.
- Evidenton sjellje që mund të rrezikojnë sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve.
- Monitoron situata që lidhen me agresivitetin, izolimin social, vandalizmin ose sjellje të tjera problematike.
- Informon strukturat përgjegjëse për rastet që kërkojnë ndërhyrje ose mbështetje.
- Ndërmerr masa parandaluese për shmangien e përshkallëzimit të situatave problematike.
- Vëzhgon tregues që mund të sinjalizojnë problematika sociale, emocionale ose të sjelljes.
- Evidenton ndryshime të sjelljes ose situata që kërkojnë vëmendje institucionale.
- Referon rastet te strukturat kompetente sipas procedurave institucionale.
- Monitoron vazhdimisht situatat dhe rastet e evidentuara.
- Ndjek respektimin e masave dhe të rekomandimeve të përcaktuara për rastet.
- Ndërhyn në kohë për të parandaluar situata që mund të cenojnë sigurinë dhe rendin në shkollë.
- Përdor komunikim profesional dhe teknika të menaxhimit të situatave problematike.
- Ndërvepron me strukturat përgjegjëse për zbatimin e masave parandaluese.
- Evidenton efektivitetin e ndërhyrjeve dhe nevojën për masa shtesë.
- Respekton kufijtë profesionalë dhe procedurat institucionale gjatë ndërhyrjes.

## Standardi 6: Edukimi dhe ndërgjegjësimi për sigurinë

### Përkufizimi i standardit

Oficeri i sigurisë planifikon dhe zhvillon veprimtari edukuese dhe ndërgjegjëse, që synojnë promovimin e kulturës së sigurisë, parandalimin e sjelljeve me rrezik dhe fuqizimin e nxënësve, të stafit dhe të prindërve për të vepruar në mënyrë të sigurt, të përgjegjshme dhe qytetare brenda dhe jashtë institucionit arsimor.

### Përshkrimi i standardit

Ky standard lidhet me rolin edukues dhe parandalues të oficerit të sigurisë në shkollë. Oficeri i sigurisë kontribuon në krijimin e një mjedisi të sigurt fizik, emocional dhe digjital, përmes informimit, sensibilizimit dhe edukimit të komunitetit shkollor, mbi çështje që lidhen me sigurinë, respektin, bashkëjetesën, përdorimin e sigurt të teknologjisë dhe përgjegjësinë qytetare. Veprimtaritë zhvillohen në bashkëpunim me drejtuesit, stafin pedagogjik, ShPS-në, Policinë e Shtetit, prindërit dhe institucione të tjera mbështetëse.

### *Oficeri i sigurisë:*

- Harton planifikime mujore ose periodike të aktiviteteve ndërgjegjëse mbi sigurinë dhe parandalimin.
- Organizon takime informuese, orë sensibilizuese, forume, diskutime dhe aktivitete edukuese me nxënësit.
- Përdor metoda ndërvepruese, si diskutime, raste studimore, simulime dhe punë në grup.
- Përfshin tema që lidhen me dhunën, konfliktet, substancat e dëmshme, sigurinë fizike dhe psikologjike.
- Koordinohet me ShPS-në, mësuesit dhe strukturat drejtuese për organizimin e aktiviteteve parandaluese.
- Informon nxënësit për rregulloren e institucionit arsimor dhe normat e sjelljes.
- Zhvillon aktivitete ndërgjegjëse mbi përgjegjësinë ligjore dhe pasojat e sjelljeve të rrezikshme.
- Shpjegon në mënyrë të përshtatshme për moshën, të drejtat dhe detyrimet e nxënësve.
- Promovon respektimin e ligjit, të institucioneve dhe të rregullave të bashkëjetesës.
- Bashkëpunon me Policinë e Shtetit ose institucione të tjera për edukimin ligjor të nxënësve.
- Informon nxënësit mbi rreziqet që lidhen me internetin dhe komunikimin online.
- Edukon mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë në internet.
- Këshillon nxënësit për përdorimin e sigurt të rrjeteve sociale dhe të platformave digjitale.

- Ndërgjegjëson për pasojat e shpërndarjes së përmbajtjeve të papërshtatshme ose të dhunshme.
- Raporton dhe referon rastet që lidhen me rrezikshmëri online, sipas procedurave përkatëse.
- Zhvillon aktivitete parandaluese mbi bullizmin, cyberbullizmin dhe format e tjera të dhunës.
- Identifikon situata që mund të ndikojnë në përjashtimin social ose konfliktet ndërmjet nxënësve.
- Nxiti raportimin e rasteve të bullizmit në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale.
- Nxiti respektin, tolerancën dhe komunikimin pozitiv ndërmjet nxënësve.
- Mbështet aktivitete që promovojnë gjithëpërfshirjen dhe respektimin e diversitetit.
- Angazhon nxënësit në iniciativa komunitare dhe aktivitete me karakter social dhe edukativ.
- Promovon kulturën e dialogut dhe të zgjidhjes paqësore të konflikteve.
- Mbështet strukturat e shkollës për krijimin e një klime pozitive dhe të sigurt.
- Organizon takime informuese me prindërit mbi sigurinë, përdorimin e internetit dhe sjelljet me rrezik.
- Bashkëpunon me institucione lokale dhe organizata për aktivitete ndërgjegjëse.
- Informon prindërit mbi mënyrat e mbështetjes së fëmijëve në përdorimin e sigurt të teknologjisë.
- Merr pjesë në aktivitete komunitare që lidhen me sigurinë dhe qytetarinë.
- Nxiti komunikimin e vazhdueshëm ndërmjet shkollës dhe familjes për çështje të sigurisë.

## Standardi 7: Zhvillimi i vazhdueshëm dhe rritja profesionale

### Përkufizimi i standardit:

Oficeri i sigurisë angazhohet në zhvillim të vazhdueshëm profesional, reflekton mbi praktikën e tij dhe ndërmerr masa për përmirësimin e kompetencave profesionale, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit dhe të garantimit të sigurisë në institucionin arsimor.

### Përshkrimi i standardit:

Ky standard lidhet me aftësinë e oficerit të sigurisë për të zhvilluar kompetencat profesionale në mënyrë të vazhdueshme, për të analizuar praktikën e punës dhe për të rritur efektivitetin e tij në përmbushjen e detyrave. Oficeri i sigurisë duhet të marrë pjesë në trajnime, të përditësojë njohuritë mbi procedurat, legjislacionin dhe qasjet bashkëkohore të sigurisë, si dhe të përdorë procesin e vetëreflektimit profesional për të identifikuar nevojat për zhvillim dhe përmirësim të mëtejshëm.

### Oficeri i sigurisë:

- Analizon në mënyrë periodike realizimin e detyrave dhe të përgjegjësiwe funksionale.
- Identifikon pikat e forta dhe nevojat për përmirësim profesional.
- Reflekton mbi efektivitetin e ndërhyrjeve dhe të veprimeve të realizuara në institucion.
- Vlerëson aftësitë profesionale në raport me kërkesat e tij funksionale dhe institucionale.
- Përdor instrumente ose forma vetëvlerësimi për analizimin e praktikës profesionale.
- Evidenton rezultatet dhe problematikat e hasura gjatë ushtrimit të detyrës.
- Merr pjesë në trajnime, seminare, workshop-e dhe aktivitete profesionale, që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen në shkollë.
- Përditëson njohuritë mbi legjislacionin, procedurat dhe praktikat bashkëkohore të sigurisë.
- Zhvillon kompetenca profesionale në menaxhimin e rasteve, komunikimin, ndërhyrjen dhe përdorimin e teknologjisë.
- Ndjek aktivitete formuese për sigurinë digjitale, emergjencat, parandalimin e dhunës dhe bashkëpunimin institucional.
- Zbaton në praktikë njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë trajnimeve.
- Ndan përvojat dhe praktikat profesionale me kolegët dhe strukturat e institucionit.
- Analizon situatat dhe rastet e trajtuara për të përmirësuar mënyrën e ndërhyrjes.
- Vlerëson efektivitetin e bashkëpunimit me strukturat dhe aktorët institucionalë.

- Reflekton mbi vendimmarrjen profesionale dhe menaxhimin e situatave problematike.
- Identifikon praktikat efektive dhe sfidat në ushtrimin e funksionit.
- Përdor reflektimin profesional për të përmirësuar komunikimin dhe qasjen ndaj rasteve.
- Kërkon feedback profesional nga drejtuesit ose strukturat mbështetëse.
- Harton objektiva personale për zhvillimin dhe përmirësimin profesional.
- Ndjek praktika dhe modele efektive të punës, në fushën e sigurisë shkollore.
- Përditëson vazhdimisht njohuritë dhe aftësitë profesionale, sipas kërkesave të funksionit.
- Zbaton rekomandimet e dala nga proceset e monitorimit dhe të reflektimit profesional.
- Kërkon mbështetje profesionale ose mentorim në raste të nevojshme.
- Kontribuon në përmirësimin e praktikave institucionale të sigurisë.

## Standardi 8: Etika dhe integriteti profesional

### Përkufizimi i standardit

Oficeri i sigurisë ushtron funksionin e tij me etikë profesionale, integritet moral dhe përgjegjësi institucionale, duke respektuar të drejtat e fëmijëve, konfidencialitetin, barazinë dhe normat ligjore e profesionale në çdo veprim dhe ndërveprim në institucionin arsimor.

### Përshkrimi i standardit

Ky standard lidhet me sjelljen profesionale dhe vlerat etike, që duhet të karakterizojnë oficerin e sigurisë gjatë ushtrimit të detyrës. Oficeri i sigurisë duhet të demonstrojë korrektësi, paanshmëri, vetëkontroll dhe respekt ndaj dinjitetit njerëzor, duke garantuar mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë të çdo nxënësi dhe anëtar të komunitetit shkollor. Ai duhet të veprojë në përputhje me legjislacionin, standardet profesionale dhe parimet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

### *Oficeri i sigurisë:*

- Respekton normat etike dhe rregullat institucionale gjatë ushtrimit të funksionit.
- Komunikon në mënyrë korrekte, profesionale dhe respektuese me nxënësit, stafin dhe prindërit.
- Mban qëndrim të paanshëm dhe profesional, në situata konfliktuale ose problematike.
- Përdor gjuhë dhe sjellje të përshtatshme me mjedisin arsimor.
- Respekton hierarkinë institucionale dhe procedurat administrative.
- Përfaqëson institucionin me dinjitet dhe përgjegjësi në bashkëpunimet institucionale dhe komunitare.
- Ushtron detyrën me ndershmëri, korrektësi dhe përgjegjësi institucionale.
- Shmang konfliktin e interesit dhe përdorimin e funksionit për përfitime personale.
- Merr vendime të bazuara në ligj, etikë profesionale dhe interesin më të lartë të nxënësit.
- Respekton standardet profesionale në çdo ndërhyrje ose veprim institucional.
- Mban qëndrim të drejtë dhe transparent në trajtimin e situatave dhe të rasteve.
- Refuzon çdo formë presioni, favorizimi ose ndikimi të papërshtatshëm.
- Ruan qetësinë dhe kontrollin emocional në situata tensioni ose emergjente.
- Menaxhon konfliktet dhe komunikimin në mënyrë profesionale dhe të kontrolluar.
- Reagon pa përdorur gjuhë fyese, kërcënuese ose sjellje agresive.
- Vepron në mënyrë të matur dhe të përgjegjshme në situata provokuese ose sensitive.
- Kontrollon reagimet personale gjatë ndërhyrjeve me nxënësit ose komunitetin shkollor.

- Kërkon mbështetje profesionale në situata që tejkalojnë kompetencat emocionale ose funksionale.
- Ruan konfidencialitetin e informacionit që lidhet me nxënësit, stafin dhe rastet e trajtuara.
- Kufizon shpërndarjen e informacionit vetëm te strukturat dhe personat e autorizuar.
- Përdor informacionin vetëm për qëllime profesionale dhe institucionale.
- Respekton procedurat për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit sensitiv.
- Shmang diskutimin ose publikimin e informacionit konfidencial në mjedise të papërshtatshme.
- Informon strukturat përgjegjëse në rastet e cenimit të konfidencialitetit.
- Vepron në përputhje me parimet dhe legjislacionin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Garanton trajtim të sigurt, dinjitoz dhe respektues për çdo nxënë.
- Merr parasysh interesin më të lartë të fëmijës në vendimmarrje dhe ndërhyrje.
- Ndërhyn në rastet e cenimit të të drejtave ose të mirëqenies së nxënësve.
- Promovon mbrojtjen, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e nxënësve në jetën shkollore.
- Koordinohet me strukturat përkatëse për mbrojtjen dhe referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë.
- Trajton të gjithë nxënësit dhe anëtarët e komunitetit shkollor në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.
- Shmang çdo formë paragjykimi mbi bazë gjinie, aftësie, statusi social, etnie, bindjeje ose karakteristike tjetër.
- Ndërhyn në rastet e diskriminimit, të përjashtimit ose të trajtimit të padrejtë.
- Promovon respektin, gjithëpërfshirjen dhe tolerancën në institucionin arsimor.
- Respekton të drejtat dhe dinjitetin e çdo individi gjatë ushtrimit të funksionit.

## Standardi 9: Komunikimi dhe ndërveprimi me nxënësit

### Përkufizimi i standardit

Oficeri i sigurisë komunikon dhe ndërvepron me nxënësit në mënyrë profesionale, etike dhe mbështetëse, duke ndërtuar marrëdhënie besimi, respekti dhe sigurie, si dhe duke përdorur teknika të përshtatshme për menaxhimin e konflikteve dhe të situatave problematike.

### Përshkrimi i standardit

Ky standard lidhet me aftësinë e oficerit të sigurisë për të krijuar komunikim efektiv dhe marrëdhënie pozitive me nxënësit, duke respektuar moshën, nevojat dhe dinjitetin e tyre. Oficeri i sigurisë duhet të përdorë komunikim të qartë, të kontrolluar dhe jo kërcënues, duhet të ndërhyjë në mënyrë profesionale në situata konflikti dhe duhet të kontribuojë në krijimin e një klime të sigurt dhe mbështetëse në institucionin arsimor. Qasja e tij duhet të bazohet në respekt, empati, vetëkontroll dhe parandalim të përshkallëzimit të situatave.

### *Oficeri i sigurisë:*

- Përdor gjuhë të qartë, të respektueshme dhe profesionale gjatë komunikimit me nxënësit.
- Dëgjon në mënyrë aktive dhe respekton mendimet dhe shqetësimet e nxënësve.
- Përshtat komunikimin sipas situatës dhe nevojave të nxënësit.
- Shmang komunikimin agresiv, kërcënues ose paragjykses.
- Ruan qetësinë dhe kontrollin emocional gjatë ndërveprimit me nxënësit.
- Respekton kufijtë profesionalë dhe etikë gjatë komunikimit.
- Krijon klimë komunikimi të hapur dhe mbështetëse në institucion.
- Nxiti nxënësit të raportojnë shqetësime ose situata që cenojnë sigurinë.
- Demonstron sjellje të drejtë, të paanshme dhe mbështetëse ndaj nxënësve.
- Respekton privatësinë dhe konfidencialitetin gjatë komunikimit me nxënësit.
- Promovon ndjenjën e sigurisë dhe të mirëqenies në komunitetin shkollor.
- Përdor komunikim të kontrolluar dhe të qetë në situata konflikti ose tensioni.
- Shmang përshkallëzimin e situatës përmes toneve, gjuhës ose sjelljeve provokuese.
- Përdor teknika verbale për qetësimin dhe orientimin e nxënësve.
- Menaxhon komunikimin në mënyrë profesionale gjatë situatave emocionale ose agresive.
- Ruan distancën profesionale dhe kontrollin e situatës gjatë ndërhyrjes.

- Kërkon mbështetje nga strukturat përgjegjëse në rastet që tejkalojnë kompetencat funksionale.
- Identifikon dhe ndërhyt në kohë në situata konflikti ndërmjet nxënësve.
- Promovon dialogun dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve.
- Trajton konfliktet me paanshmëri dhe respekt për të gjitha palët e përfshira.
- Shmang përdorimin e forcës ose të komunikimit kërcënues gjatë ndërhyrjes.
- Trajton çdo nxënës me respekt dhe dinjitet, pavarësisht sjelljes ose situatës.
- Shmang etiketimin, diskriminimin ose poshtërimin e nxënësve.
- Respekton të drejtat dhe privatësinë e nxënësve gjatë ndërhyrjeve dhe komunikimit.
- Merr parasysh interesin më të lartë të nxënësit në çdo ndërveprim profesional.
- Vepron në mënyrë etike dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve.
- Ndërhyt për mbrojtjen e nxënësve në rastet e cenimit të dinjitetit ose të drejtave të tyre.
- Përdor mënyra komunikimi të përshtatshme sipas moshës dhe nivelit të zhvillimit të nxënësve.
- Shpjegon rregullat dhe udhëzimet e sigurisë në mënyrë të kuptueshme për grupmosha të ndryshme.
- Merr parasysh nevojat emocionale, sociale dhe zhvillimore të nxënësve gjatë komunikimit.
- Përdor qasje mbështetëse dhe edukative në ndërveprimin me fëmijët dhe adoleshentët.
- Përshtat ndërhyrjen dhe mënyrën e komunikimit në raste të veçanta ose sensitive.

## Standardi 10: Bashkëpunimi institucional dhe ndërinstitutional

### Përkufizimi i standardit

Oficeri i sigurisë bashkëpunon në mënyrë profesionale dhe të koordinuar me strukturat e institucionit arsimor, familjen dhe institucionet e tjera përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve, duke kontribuar në menaxhimin efektiv të problematikave dhe krijimin e një mjedisi të sigurt shkollor.

### Përshkrimi i standardit

Ky standard lidhet me aftësinë e oficerit të sigurisë për të ndërtuar dhe për të mbajtur bashkëpunim funksional me drejtuesit e institucionit, stafin pedagogjik, shërbimin psiko-social, Policinë e Shtetit, prindërit dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijëve. Bashkëpunimi institucional dhe ndërinstitutional është thelbësor për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve, që cenojnë sigurinë dhe mirëqenien në shkollë. Oficeri i sigurisë duhet të komunikojë në mënyrë profesionale, duhet të respektojë kompetencat institucionale dhe duhet të kontribuojë në koordinimin e ndërhyrjeve dhe të masave mbështetëse.

### *Oficeri i sigurisë:*

- Informon drejtuesit mbi situatat dhe problematikat që lidhen me sigurinë në shkollë.
- Merr pjesë në planifikimin dhe zbatimin e masave institucionale të sigurisë.
- Konsultohet me drejtorinë për organizimin e aktiviteteve parandaluese dhe të ndërhyrjeve institucionale.
- Respekton procedurat administrative dhe hierarkinë institucionale gjatë ushtrimit të funksionit.
- Propozon masa për përmirësimin e sigurisë fizike dhe organizative të institucionit.
- Evidenton problematikat dhe nevojat institucionale përmes raportimit profesional.
- Komunikon me mësuesit për problematikat që ndikojnë në sigurinë dhe klimën shkollore.
- Mbështet stafin pedagogjik në identifikimin dhe menaxhimin e situatave me risk.
- Bashkëpunon për monitorimin e sjelljeve problematike dhe të rasteve të konfliktit.
- Merr pjesë në aktivitete dhe takime që lidhen me sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve.
- Ndihmon në zbatimin e rregullave dhe të masave parandaluese në institucion.
- Respekton rolet dhe kompetencat e stafit pedagogjik gjatë bashkëpunimit profesional.
- Koordinon veprimet me ShPS-në për identifikimin dhe trajtimin e rasteve problematike.

- Referon rastet që kërkojnë ndërhyrje psiko-sociale sipas procedurave institucionale.
- Merr pjesë në takime dhe analiza të rasteve që lidhen me sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve.
- Shkëmben informacion profesional, duke respektuar konfidencialitetin dhe kompetencat funksionale.
- Mbështet zbatimin e aktiviteteve parandaluese dhe ndërgjegjësuere në shkollë.
- Ndjek rekomandimet dhe planet e ndërhyrjes të hartuara në bashkëpunim me ShPS-në.
- Informon strukturat e Policisë së Shtetit për rastet që kërkojnë ndërhyrje institucionale.
- Informon specialistin për policimin në komunitet dhe SPZ-në, për çështje të sigurisë në shkollë.
- Merr pjesë në aktivitete sensibilizuese dhe parandaluese të organizuara në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.
- Respekton procedurat ligjore dhe institucionale gjatë shkëmbimit të informacionit.
- Raporton në periudha javore sipas formateve të miratuara të SPZ-ja që mbulon shkollën.
- Koordinon veprimet në rastet e incidenteve ose të situatave emergjente.
- Lehtëson komunikimin dhe ndërhyrjen e strukturave të rendit në institucion sipas procedurave.
- Informon prindërit mbi situata që ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve.
- Komunikon në mënyrë profesionale dhe respektuese me familjet e nxënësve.
- Bashkëpunon me prindërit për parandalimin dhe menaxhimin e sjelljeve problematike.
- Merr pjesë në takime dhe aktivitete ndërgjegjësuere me prindërit.
- Respekton konfidencialitetin dhe kufijtë profesionalë gjatë komunikimit me familjet.
- Ndihmon në forcimin e bashkëpunimit shkollë-familje për çështjet e sigurisë.
- Ndërvepron me institucionet sociale, shëndetësore dhe komunitare për mbrojtjen e nxënësve.
- Merr pjesë në struktura ose mekanizma ndërinstitutionalë për menaxhimin e rasteve.
- Shkëmben informacion profesional, duke respektuar konfidencialitetin dhe legjislacionin në fuqi.
- Ndjek rastet e referuara dhe bashkëpunon për zbatimin e masave mbështetëse.
- Kontribuon në koordinimin institucional për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve.

## Standardi 11: Referimi dhe menaxhimi i rasteve

### Përkufizimi i standardit

Oficeri i sigurisë identifikon, referon, dokumenton dhe ndjek rastet që cenojnë sigurinë, mirëqenien dhe mbrojtjen e nxënësve, duke bashkëpunuar me strukturat përgjegjëse dhe duke respektuar konfidencialitetin dhe procedurat institucionale e ligjore.

### Përshkrimi i standardit

Ky standard lidhet me aftësinë e oficerit të sigurisë për të menaxhuar në mënyrë profesionale rastet që kërkojnë ndërhyrje institucionale ose ndërinstitutionale. Oficeri i sigurisë duhet të identifikojë në kohë situatat problematike, duhet të ndjekë procedurat e referimit, duhet të dokumentojë rastet dhe duhet të bashkëpunojë me strukturat mbështetëse për mbrojtjen dhe mirëqenien e nxënësve. Procesi i menaxhimit të rasteve duhet të garantojë konfidencialitetin, gjurmueshmërinë dhe respektimin e të drejtave të fëmijës.

### *Oficeri i sigurisë:*

- Evidenton situata dhe sjellje që cenojnë sigurinë, mirëqenien ose të drejtat e nxënësve.
- Identifikon raste që lidhen me dhunën, bullizmin, neglizhencën, përdorimin e substancave ose problematika të tjera sociale dhe emocionale.
- Monitoron treguesit e riskut dhe ndryshimet në sjelljen e nxënësve.
- Vlerëson nevojën për referim ose ndërhyrje të specializuar sipas situatës.
- Ndërhyn në mënyrë të menjëhershme në rastet që paraqesin rrezik për sigurinë e nxënësit ose të komunitetit shkollor.
- Referon rastet te strukturat kompetente sipas procedurave institucionale dhe ligjore.
- Plotëson dokumentacionin e referimit në mënyrë të saktë dhe profesionale.
- Informon drejtuesit dhe strukturat përgjegjëse për rastet që kërkojnë ndërhyrje.
- Respekton afatet dhe procedurat për trajtimin dhe referimin e rasteve.
- Siguron që referimi të realizohet në interesin më të lartë të fëmijës.
- Harton dokumentacion të plotë dhe të strukturuar për rastet e trajtuara.
- Evidenton kronologjinë e ngjarjeve, të ndërhyrjeve dhe të veprimeve të realizuara.
- Ruan evidencat dhe dokumentacionin sipas procedurave institucionale.
- Administron dosjet e rasteve në mënyrë të organizuar dhe të sigurt.
- Përditëson informacionin dhe evidencat gjatë ndjekjes së rastit.
- Përdor gjuhë profesionale, objektive dhe të verifikueshme në dokumentim.
- Ruan konfidencialitetin e informacionit që lidhet me rastet dhe personat e përfshirë.
- Kufizon aksesin në dokumentacion vetëm për strukturat dhe personat e autorizuar.
- Shmang shpërndarjen e informacionit sensitiv jashtë procedurave institucionale.

- Respekton privatësinë dhe dinjitetin e nxënësve gjatë trajtimit të rasteve.
- Administron dokumentacionin fizik dhe digjital sipas rregullave të sigurisë së informacionit.
- Informon strukturat përgjegjëse në rastet e cenimit të konfidencialitetit.
- Monitoron zbatimin e masave dhe të rekomandimeve të përcaktuara për rastet.
- Mban komunikim me strukturat përgjegjëse dhe aktorët e përfshirë në trajtimin e rastit.
- Evidenton progresin, problematikat dhe nevojat e mëtejshme gjatë ndjekjes së rastit.
- Ndërmerr veprime shtesë në rastet kur situata përkeqësohet ose nuk stabilizohet.
- Informon drejtuesit dhe strukturat përkatëse mbi zhvillimin e rasteve sipas procedurave.
- Ndjek rastet deri në stabilizimin ose përfundimin e procesit të ndërhyrjes.
- Bashkëpunon me ShPS-në, NjMF-në, Policinë e Shtetit dhe institucione të tjera për trajtimin e rasteve.
- Merr pjesë në takime ndërinstitutionale dhe analiza të rasteve sipas procedurave.
- Shkëmben informacion profesional, duke respektuar konfidencialitetin dhe kompetencat institucionale.
- Koordinon veprimet dhe masat mbështetëse për mbrojtjen dhe mirëqenien e nxënësit.
- Ndiemon në zbatimin e planeve të ndërhyrjes dhe të masave mbështetëse.
- Evidenton nevojat për mbështetje shtesë ose ndërhyrje të specializuara.

# TERMAT KRYESORE

|                                      |                                                                                                                                                                                                                                     |
|--------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Oficeri i sigurisë (OS)</b>       | Punonjësi i angazhuar në institucionin arsimor parauniversitar, me rol parandalues, mbështetës dhe koordinues në funksion të garantimit të sigurisë në shkollë dhe përreth saj.                                                     |
| <b>Siguria në shkollë</b>            | Tërësia e masave parandaluese, organizative, fizike dhe bashkëpunuese, që synojnë mbrojtjen e nxënësve, të stafit dhe të komunitetit shkollor nga rreziqet dhe dukuritë negative.                                                   |
| <b>Parandalimi</b>                   | Ndërhyrja e hershme për identifikimin, evidentimin dhe minimizimin e faktorëve të riskut, që cenojnë sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve.                                                                                            |
| <b>Incident</b>                      | Çdo ngjarje apo situatë që cenon ose mund të cenojë sigurinë fizike, emocionale apo sociale të nxënësve, të stafit apo të institucionit arsimor.                                                                                    |
| <b>Situatë emergjente</b>            | Çdo situatë që kërkon reagim të menjëhershëm për mbrojtjen e jetës, të shëndetit ose të sigurisë së komunitetit shkollor.                                                                                                           |
| <b>Referim</b>                       | Procesi institucional i përcjelljes së një rasti pranë strukturave përgjegjëse për trajtim, mbështetje apo ndërhyrje të specializuara.                                                                                              |
| <b>Dokumentim profesional</b>        | Procesi i evidentimit dhe i regjistrimit të veprimtarisë profesionale të oficerit të sigurisë, përmes formularëve, raporteve, procesverbaleve dhe instrumenteve të tjera zyrtare.                                                   |
| <b>Bashkëpunim ndërinstitutional</b> | Koordinimi dhe ndërveprimi ndërmjet oficerit të sigurisë dhe institucioneve apo strukturave të tjera përgjegjëse për sigurinë, mbrojtjen dhe mirëqenien e nxënësve.                                                                 |
| <b>Interesi më i lartë i fëmijës</b> | Parim themelor që udhëheq çdo veprim dhe vendimmarrje në funksion të mbrojtjes dhe të mirëqenies së fëmijës.                                                                                                                        |
| <b>Sinjalizimi i hershëm</b>         | Sinjalizimi i hershëm është procesi i identifikimit dhe i evidentimit në kohë të treguesve, të sjelljeve ose të situatave që mund të përbëjnë rrezik për sigurinë, mirëqenien ose mbrojtjen e nxënësve dhe të komunitetit shkollor. |

|                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|---------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>De-eskalimi</b>                                      | De-eskalimi është procesi i përdorimit të teknikave verbale, emocionale dhe sjellore për uljen e tensionit, qetësimin e situatave konfliktuale dhe parandalimin e përshkallëzimit të agresivitetit ose të dhunës.                                                                                                         |
| <b>NjMF (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës)</b>             | Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës (NjMF) është struktura përgjegjëse në nivel vendor për identifikimin, referimin, koordinimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.                                                                                                                                   |
| <b>Kontroll fizik (Ndërhyrje fizike proporcionale):</b> | Masa ekstreme dhe e fundit e ndërhyrjes fizike nga oficeri i sigurisë, e zbatuar ekskluzivisht në situata emergjence, kur ekziston një rrezik i menjëhershëm për jetën, shëndetin ose integritetin fizik të nxënësit apo të personave të tjerë, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe të mbrojtjes së fëmijës. |
| <b>Perimetri i sigurisë së shkollës</b>                 | Hapësira fizike që përfshin mjediset e brendshme, oborrin, rrethimin, si dhe zonën e jashtme të menjëhershme përreth institucionit arsimor, brenda së cilës oficeri i sigurisë ushtron funksionin e monitorimit dhe të parandalimit në koordinim me strukturat e policimit në komunitet.                                  |
| <b>Klimë e sigurt shkollore</b>                         | Mjedi psikologjik, social dhe fizik i shkollës, i cili bazohet në marrëdhënie besimi, respekti për diversitetin dhe mungesë të frikës apo të intimidimit, ku çdo nxënës ndihet i mbrojtur, i dëgjuar dhe i përfshirë pa asnjë lloj diskriminimi.                                                                          |
| <b>Cyberbullying (Bullizmi virtual/digjital)</b>        | Çdo formë e qëllimshme, e përsëritur dhe armiqësore e bullizmit, e ngacmimit, e denigrimit apo e intimidimit të nxënësve, që realizohet përmes përdorimit të teknologjisë, rrjeteve sociale, platformave digjitale apo emailit institucional.                                                                             |
| <b>Risk operativ/infrastrukturor</b>                    | Çdo dëmtim, defekt ose mangësi në mjedisin fizik të shkollës (si thyerje rrethimi, mungesë ndriçimi, bllokim i daljeve të emergjencës apo defekt i sistemeve CCTV), që cenon sigurinë faktike të komunitetit shkollor.                                                                                                    |
| <b>Memo</b>                                             | Formati zyrtar i komunikimit të brendshëm shkresor, përmes të cilit oficeri i sigurisë sinjalizon në mënyrë parandaluese dhe formale drejtuesin e institucionit mbi problematikën, risqet e evidentuara apo nevojat për ndërhyrje.                                                                                        |

# BAZA LIGJORE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

VKM nr. 733, datë 20.10.2016, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe të planit të veprimit”.

VKM nr. 98, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”.

VKM nr. 99, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP)”, i ndryshuar.

VKM nr. 1155, datë 24.12.2020, “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të numrit thelbësor dhe të kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”.

“Plani kombëtar për personat me AK, 2021–2025”, i miratuar me VKM-në nr. 276, datë 12.5.2021.

“Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe planin e veprimit për zbatimin e saj”, e miratuar me VKM-në nr. 621, datë 22.10.2021.

“Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026”, e miratuar me VKM-në nr. 659, datë 3.11.2021.

“Strategjia kombëtare e mbrojtjes sociale 2024-2030 dhe e planit të veprimit në zbatim të saj”, e miratuar me VKM-në nr. 152, datë 13.3.2024.

“Plani kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025)”, i miratuar me VKM-në nr. 701, datë 18.11.2021.

“Programi kombëtar për aktivitetet jashtë orarit mësimor dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”, i miratuar me VKM-në nr. 606, datë 14.9.2022.

“Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.

Udhëzimi nr. 30, datë 02.08.2013, “Për rregulloren Tip të institucioneve arsimore”.

Udhëzimi nr. 10, datë 25.02.2015, katërmistror midis Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë, “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik, për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.

Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015, “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe nxënësve, si dhe përmbytjen e dosjeve të tyre personale”, i ndryshuar.

Udhëzim nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të institucionit arsimor”.

Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar me udhëzimin nr.15, datë 13.03.2025.

Udhëzimi nr. 16, datë 22.07.2024, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.

Udhëzimi nr. 23, datë 01.09.2025, “Për caktimin e rregullave dhe masave për ndalimin e përdorimit të telefonit celular dhe pajisjeve të ndërlidhura me të në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare”.

Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, “Për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psiko-social, në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”.

Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 363 prot., datë 25.1.2016 dhe nr. 600 prot., datë 25.1.2016, “Për edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë”, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Standardet e shkollës miqësore për fëmijët në Shqipëri: UNICEF, 2011

Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare (SHQK), IZHA, 2014.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar. (2025). Praktika e Punës së Oficerëve të Sigurisë (rishikuar). Tiranë.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar. (2025). Parimet për Etikën Profesionale të Oficerit të Sigurisë. Tiranë.

# REFERENCAT

Assigning Police Officers to Schools, [https://popcenter.asu.edu/sites/g/files/litvpz3631/files/assigning\\_police\\_officers\\_to\\_schools.pdf](https://popcenter.asu.edu/sites/g/files/litvpz3631/files/assigning_police_officers_to_schools.pdf);

Bandura, A. (1977). *Social learning theory*. EngleWood Cliffs, NJ: Prentice Hall.

Best Practices School Resource Officer Program Recommendations [https://WWW.nasro.org/clientuploads/NASRO\\_BestPractices21.pdf](https://WWW.nasro.org/clientuploads/NASRO_BestPractices21.pdf):

Bronfenbrenner, U. (1979). *The ecology of human development: Experiments by nature and design*. Cambridge, MA: Harvard University Press.

*Child protection in schools: A frameWork for action*. NeW York, NY: UNICEF. (2016).

Cohen, J., McCabe, E. M., Michelli, N. M., & Pickeral, T. (2009). School climate: Research, policy, practice, and teacher education. *Teachers College Record*.

*Convention on the Rights of the Child*. NeW York, NY: United Nations. (1989).

Council of Europe. (2018). *Guidelines on child-friendly education and child protection*. Strasbourg, France: Council of Europe.

CREATING SAFE SCHOOLS: SCHOOL SAFETY REPORT ON HIGH SCHOOLS (2023), [https://advocacy-center.org/Wp-content/uploads/2024/04/School-Safety-Report\\_November-2023.pdf](https://advocacy-center.org/Wp-content/uploads/2024/04/School-Safety-Report_November-2023.pdf);

DEFINING THE ROLE OF SCHOOL-BASED POLICE OFFICERS , [https://WWW.policinginstitute.org/Wp-content/uploads/2016/10/PF\\_IssueBriefs\\_Defining-the-Role-of-School-Based-Police-Officers\\_FINAL.pdf](https://WWW.policinginstitute.org/Wp-content/uploads/2016/10/PF_IssueBriefs_Defining-the-Role-of-School-Based-Police-Officers_FINAL.pdf);

EURODICE, Education on Online Safety in Schools in Europe , [https://eurydice.indire.it/Wp-content/uploads/2017/06/Online\\_safety\\_in\\_schools.pdf](https://eurydice.indire.it/Wp-content/uploads/2017/06/Online_safety_in_schools.pdf);

European Commission. (2019). *Key competences for lifelong learning*. Brussels, Belgium: European Union.

Goleman, D. (1995). *Emotional intelligence*. NeW York, NY: Bantam Books.

Guidelines on School Safety and Security , Council of Europe Policy guidelines on integrated national strategies for the protection of children from violence, [https://dsel.education.gov.in/sites/default/files/2021-10/guidelines\\_sss.pdf](https://dsel.education.gov.in/sites/default/files/2021-10/guidelines_sss.pdf);

Guiding Principles for School Resource Officer Programs,  
[https://WWW.nasro.org/clientuploads/resources/e032218006 -  
\\_SRO Guidelines v2.pdf](https://WWW.nasro.org/clientuploads/resources/e032218006_-_SRO_Guidelines_v2.pdf);

Guiding Principles for School, Resource Officer Programs,  
[https://WWW.dcjs.virginia.gov/sites/dcjs.virginia.gov/files/doj\\_cops\\_office\\_2022\\_guiding\\_principles\\_for\\_school\\_resource\\_officers.pdf](https://WWW.dcjs.virginia.gov/sites/dcjs.virginia.gov/files/doj_cops_office_2022_guiding_principles_for_school_resource_officers.pdf);

[https://WWW.ndsu.edu/sites/default/files/fileadmin/emgt/ASIS\\_SPC.1-2009\\_Item\\_No.\\_1842.pdf](https://WWW.ndsu.edu/sites/default/files/fileadmin/emgt/ASIS_SPC.1-2009_Item_No._1842.pdf)

[https://WWW.ndsu.edu/sites/default/files/fileadmin/emgt/ASIS\\_SPC.1-2009\\_Item\\_No.\\_1842.pdf](https://WWW.ndsu.edu/sites/default/files/fileadmin/emgt/ASIS_SPC.1-2009_Item_No._1842.pdf);

[https://WWW.rand.org/content/dam/rand/pubs/perspectives/PEA200/PEA243-2/RAND\\_PEA243-2.pdf](https://WWW.rand.org/content/dam/rand/pubs/perspectives/PEA200/PEA243-2/RAND_PEA243-2.pdf);

<https://rm.coe.int/168046d3a0>;

K-12 SCHOOL SECURITY GUIDE 3RD EDITION | 2022 ,  
<https://WWW.cisa.gov/sites/default/files/2022-11/k12-school-security-guide-3rd-edition-022022-508.pdf>;

MANUAL ON COMPREHENSIVE SCHOOL SAFETY AND SECURITY PROGRAMME (CSSSP), <https://WWW.unicef.org/india/media/2806/file/School-Safety-Security-Manual-WestBengal.pdf>;

NASRO, NAtional association school resource officers, SCHOOL RESOURCE OFFICER PROGRAM RECOMMENDATIONS  
[https://WWW.nasro.org/clientuploads/NASRO\\_SRO\\_Recommendations.pdf](https://WWW.nasro.org/clientuploads/NASRO_SRO_Recommendations.pdf)

OECD, School Safety and Security,  
[https://WWW.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2005/01/lessons-in-danger\\_g1gh46be/9789264017412-en.pdf](https://WWW.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2005/01/lessons-in-danger_g1gh46be/9789264017412-en.pdf);

Organization for Economic Co-operation and Development. (2019). *School Well-being and safety policies*. Paris, France: OECD.

Pupils' Well-Being Policy FrameWork of the European Schools (2022),  
<https://WWW.eursc.eu/BasicTexts/2022-01-D-6-en-2.pdf>;

Safer School Partnerships,  
<https://popcenter.asu.edu/sites/g/files/litvpz3631/files/safer-school-partnerships.pdf>:

SAVE THE CHILDREN - SAFE SCHOOLS COMMON APPROACH (SSCA, 2024) ,  
<https://school-education.ec.europa.eu/system/files/2024-04/Safe%20Schools%20Common%20Approach%20-%20detailed%20description.pdf>;

School Resource Officer (SRO) Evaluation,  
<https://WWW.calgarypolicecommission.ca/Wp-content/uploads/2021/04/Nov-2021-CPC-5.1-School-Resource-Officer-Program-Report-Public.pdf>;

School Resource Officer Program Review , <https://WWW.lacrosseschools.org/Wp-content/uploads/2022/07/School-Resource-Officer-Program-Evaluation-Report.pdf>;

SCHOOL SAFETY AND SECURITY TOOLKIT A Guide for Parents, Schools, and Communities,  
[https://WWW.ncpc.org/Wp-content/uploads/2017/11/NCPC\\_SchoolSafetyToolkit.pdf](https://WWW.ncpc.org/Wp-content/uploads/2017/11/NCPC_SchoolSafetyToolkit.pdf);

*School safety and violence prevention: Global guidance*, UNESCO (2017).

School Safety Audit Checklist,  
<https://WWW.cde.state.co.us/sites/default/files/documents/fedprograms/dl/ov tiv mt oi schsafetyauditcklst.pdf>;

**Standards & Guidelines**, <https://WWW.asisonline.org/security-neWs/standards-guidelines/>;

The International Child Safeguarding Standards,  
[https://commission.europa.eu/document/download/f53f19ef-c655-4d63-91e5-db4fee59ca3e\\_en?filename=KCS-CS-Standards-ENG-200218.pdf](https://commission.europa.eu/document/download/f53f19ef-c655-4d63-91e5-db4fee59ca3e_en?filename=KCS-CS-Standards-ENG-200218.pdf);

UNESCO, Education 2030, Minding the dataProtecting learners' privacy and security , <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000381494>;

UNICEF, Comprehensive School Safety Framework 2022-2030 for Child Rights and Resilience in the Education Sector, [https://gadrrres.net/files/cssf\\_2022-2030\\_en.pdf](https://gadrrres.net/files/cssf_2022-2030_en.pdf);

UNICEF, Considerations for Safe Schools for Children and Adolescents,  
<https://WWW.unicef.org/romania/media/3541/file/Considerations%20for%20Safe%20Schools%20for%20Children%20and%20Adolescents.pdf>;

UNICEF, DATA PROTECTION IN SCHOOLS: GUIDANCE FOR LEGISLATORS, POLICY MAKERS AND SCHOOLS (2024),  
<https://WWW.unicef.org/eca/media/35876/file/Data%20protection%20in%20schools%20.pdf>;

UNISDR, Comprehensive School Safety,  
<https://WWW.bushfirereadyschools.com.au/sites/default/files/2018-08/CSS-FrameWork-2017.pdf>,

World Health Organization. (2020). *Preventing violence in schools: Evidence-based approaches*. Geneva, Switzerland: WHO.

Writing Guide for a Memorandum of Understanding (MOU) ,  
<https://transition.fcc.gov/pshs/docs/clearinghouse/DHS-MemorandumOfUnderstanding.pdf>

United Nations. (1989). *Convention on the Rights of the Child*. New York, NY: United Nations.

UNICEF. (2016). *Child protection in schools: A framework for action*. New York, NY: UNICEF.

UNESCO. (2017). *School safety and violence prevention: Global guidance*. Paris, France: UNESCO.

World Health Organization. (2020). *Preventing violence in schools: Evidence-based approaches*. Geneva, Switzerland: WHO.

Organisation for Economic Co-operation and Development. (2019). *School Well-being and safety policies*. Paris, France: OECD.

Bandura, A. (1977). *Social learning theory*. Englewood Cliffs, NJ: Prentice Hall.

Bronfenbrenner, U. (1979). *The ecology of human development: Experiments by nature and design*. Cambridge, MA: Harvard University Press.

Goleman, D. (1995). *Emotional intelligence*. New York, NY: Bantam Books.

Cohen, J., McCabe, E. M., Michelli, N. M., & Pickeral, T. (2009). School climate: Research, policy, practice, and teacher education. *Teachers College Record*, 111(1), 180–213.

European Commission. (2019). *Key competences for lifelong learning*. Brussels, Belgium: European Union.

Council of Europe. (2018). *Guidelines on child-friendly education and child protection*. Strasbourg, France: Council of Europe.

United Nations. (1989). *Convention on the Rights of the Child*. New York, NY: United Nations.

UNESCO. (2019). *Behind the numbers: Ending school violence and bullying*. Paris, France: UNESCO.

World Health Organization. (2020). *School violence and bullying: Global status report*. Geneva, Switzerland: WHO.

UNICEF. (2021). *Safe to learn: Call to action to end violence in schools*. New York, NY: UNICEF.

Council of Europe. (2018). *Reference framework of competences for democratic culture*. Strasbourg, France: Council of Europe.

International Labour Organization. (2021). *Code of conduct and ethics for Workplace safety and professional integrity*. Geneva, Switzerland: ILO.

National Association of School Resource Officers. (2022). *Best practices for school safety and school resource officers*. Hoover, AL: NASRO.

Organisation for Economic Co-operation and Development. (2019). *Educating 21st century children: Emotional Well-being in the digital age*. Paris, France: OECD.



# AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



**E-Mail**

[sekretaria@ascap.edu.al](mailto:sekretaria@ascap.edu.al)



**Website**

[www.ascap.edu.al](http://www.ascap.edu.al)